

SONILA BOÇI

SITUATA POLITIKE NË SHQIPËRI (TETOR-DHJETOR 1943): REZISTENCË, BASHKËPUNIM E LUFTË CIVILE

Abstrakt:

Artikulli synon të analizojë situatën politike në Shqipëri në muajt e parë të pushtimit gjerman, duke u ndalur në marrëdhëniet ndërmjet Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) me forcat e tjera politike në Shqipëri: Ballin Kombëtar dhe Partinë Nacional Zogiste (Legalitetin). Ai do të shpjegojë procesin e ideologjizimit të rezistencës shqiptare nga ana e PKSH-së, e cila u bë shkaktar i luftës civile në vend; fillimet e ravijëzimit nga ana e saj të profilit të “armikut të popullit” dhe propagandimit të rolit drejtues të PKSH-së në rezistencën shqiptare. Artikulli do të analizojë arsyet e metamorfozës politike të Ballit Kombëtar nga një organizatë e rezistencës antifashiste në një lëvizje antikomuniste e gatshme të bashkëpunonte edhe me pushtuesin nazist.

Fjalë kyçe:

Pushtimi gjerman, rezistenca, lufta civile, bashkëpunëtorët, ideologjizimi i rezistencës, Operacioni gjerman i Dimrit

Debati historiografik mbi karakterin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri

Në diskursin akademik, por edhe atë politik e publik çështja e karakterit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri prej kohësh ka zënë një vend të posaçëm. Dilema nëse Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri mori karakterin e një rezistence gjithëpopullore nacionalçlirimtare dhe antifashiste, apo ajo u shndërrua gradualisht në një luftë civile me karakter klasor ka angazhuar opinionin publik dhe qarqet akademike. Ky debat, i zhvilluar shpeshherë emocionalisht dhe jo i bazuar në logjikën e fakteve dhe argumenteve shkencore, merr përmasa aq të gjera, sa duket

sikur eklipson të gjitha aspektet e tjera të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Ndonëse për opinionin publik debati është relativisht i vonshëm, në auditoret akademike ai është shumë më i hershëm. Në historiografinë shqiptare, teza se Lufta e Dytë Botërore, veçanërisht pas pushtimit gjerman të Shqipërisë, mori edhe karakterin e një lufte civile, e cila u zhvillua krahas asaj nacionalçlirimtare, është hedhur gjatë viteve '50, kur po diskutohej drafti i parë i tekstit zyrtar të historisë së Shqipërisë, i hartuar nga Instituti i Shkencave. Ishte studiuesi Ndreçi Plasari, i cili parashtrroi tezën se lufta e klasave gjatë Luftës së Dytë Botërore mori karakterin e një lufte civile midis grupeve rivale politike, dhe, si e tillë, duhej të konsiderohej një prej aspekteve të Luftës së Dytë Botërore, së bashku me atë nacionalçlirimtar.¹ Parë në këndvështrimin ideologjik marksist-leninist, për Plasarin kjo luftë ishte nxitur nga klasat shfrytëzuese, të cilat bashkëpunuan me armikun. Teza gjeti mbështetje në një masë të konsiderueshme të mësuesve, intelektualëve, anëtarëve të PPSH-së, të cilëve iu kërkua të jepnin mendim për draftin e parë të këtij teksti. Shumë kërkuan, madje të përcaktohej viti 1943 si fillim i luftës civile, pasi në këtë kohë “borgjezia dhe feudalët shqiptarë bashkëpunuan me pushtuesin gjerman”.²

Tezat mbi karakterin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri u diskutuan dy herë në mbledhjet e Byrosë Politike në vitin 1962 dhe 1964. Disa prej anëtarëve të Byrosë Politike të KQ të PPSH-së, si: Mehmet Shehu, Liri Belishova³, Ramiz Alia⁴ mbështetën idenë se lufta e klasave në Shqipëri mori karakterin e luftës civile, por ishte kundërshtimi këmbëngulës i Enver Hoxhës, i cili frenoi anëtarët e tjerë të Byrosë Politike t'i mbështesnin këto teza. Hoxha “këshillonte” kolegët dhe bashkëluftëtarët e tij, të ishin të kujdesshëm në përdorimin e termit *luftë*

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i PPSH-së (më tej: AP), Viti (më tej: V.) 1952, Dosja (më tej: D.) 600, Fleta (më tej: fl.) 14. Relacion mbi opinionet e shprehura mbi maketin e tekstit të Historisë së Shqipërisë hartuar nga Instituti i Shkencave, pa datë.

² Po aty, F. 14/AP-Organet Udhëheqëse [më tej: OU], V. 1959, D. 14, fl. 42. Relacion i drejtorisë së Agjitacion-Propagandës në lidhje me maketin e tekstit të historisë së Shqipërisë.

³ Po aty, F. 14/AP-OU, V. 1959, D. 14, fl. 97. Diskutimi i Liri Belishovës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 6 maj 1959.

⁴ Po aty, F. 14/AP-OU, V. 1964, D. 12, fl. 229. Diskutimi i Ramiz Alisë në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 2 tetor 1964.

civile, pasi Balli Kombëtar dhe Legaliteti nuk kishin qenë gjë tjetër, veçse “mercenarë të pushtuesve”. Për Hoxhën nuk ishin qëllimet politike të PKSH-së që përcaktonin karakterin e Luftës, por sjellja dhe veprimet e kundërshtarëve politikë të saj. Gjithsesi, konkluzioni përfundimtar i drejtuesve më të lartë komunistë ishte se Lëvizja Nacionalçlirimtare kishte karakter të dyfishtë: atë antifashist dhe luftë klasash.⁵ Një ndryshim i tillë semantik u reflektua në tekstin e botuar nga Instituti i Shkencave më 1965, ku termi ‘luftë civile’ u zëvendësua me ‘luftë vëllavrasëse’. Teza e paraqitur në tekst ishte: për shkak se forcat reaksionare u bashkuan me pushtuesin nazist gjerman në luftën kundër lëvizjes nacionalçlirimtare “ato i imponuan popullit shqiptar një luftë vëllavrasëse”.⁶

Gjatë viteve ‘70, teza e luftës civile rishfaqet sporadikisht në literaturën historike. Në monografinë e prof. Luan Omarit “Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit”, ku pohohej se “duke qenë të paaftë, për t’i bërë ballë me forcat e tyre Lëvizjes Nacionalçlirimtare, organizatat dhe grupet reaksionare u lidhën më shumë me pushtuesin. Në këto kushte, Lëvizja Nacionalçlirimtare që bënte populli shqiptar kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, përveç karakterit nacionalçlirimtar merrte karakter më të theksuar klase, në formën e saj më të ashpër, atë të luftës civile”.⁷ Siç kuptohet qartë, autori konsideron shkaktarë të luftës civile “grupet reaksionare”, që kishin bashkëpunuar me pushtuesit, pra lufta civile i ishte imponuar Frontit Nacionalçlirimtar (më tej: FNÇ).

Gjatë këtyre viteve, çështja e karakterit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri u diskutua edhe në forume publike. Në referatin “Bashkimi i popullit rreth PKSH-së në Frontin Nacionalçlirimtar”, të mbajtur në *Konferencën Kombëtare të Studimeve për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare*, organizuar nga Akademia e Shkencave, në nëntor 1974, studiuesi Ndreçi Plasari do ta rishikonte disi tezën fillestare të luftës civile. Në këtë prezantim, ai kundërshtonte ekzistencën e luftës civile si një tezë e hedhur nga pushtuesit gjermanë, Balli Kombëtar, Legaliteti,

⁵ *Po aty*, F. 14/AP-OU, V. 1964, D. 12, fl. 229. Diskutimi i Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 2 tetor 1964.

⁶ *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, 1965 vëll. II, redaktorë përgjegjës: Aleks Buda, Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo, Jusuf Alibali, Ndreçi Plasari, Universiteti Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë: Mihal Duri, 1965, f. 755.

⁷ Luan Omari, *Revolucioni popullor në Shqipëri dhe çështja e pushtetit*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Tiranë: 1977, f. 13.

anglezët dhe amerikanët, por që nuk ishte pranuar nga dokumentet zyrtare të Partisë Komuniste të Shqipërisë (më tej: PKSH). Ai shprehte mendimin se, si pushtuesit italianë, ashtu edhe ata gjermanë, u përpoqën të nxisnin luftën vëllavrasëse, sepse kështu “përçanin dhe dobësonin bashkimin e popullit në FNÇ, rrjedhimisht asgjësonin Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ)”. Sipas Plasarit, kjo luftë u interesonte edhe klasave çifligare, borgjeze, bajraktarëve dhe klerit, të cilët “shikonin në zhvillimin revolucionar dhe në fitoren e Luftës Nacionalçlirimtare fundin e sundimit dhe të privilegjeve të tyre. Me shtytjen e gjermanëve këto klasa shpërthyen luftën vëllavrasëse, të cilën ia imponuan Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe Frontit Nacionalçlirimtar”. Plasari nuk pranon që Lufta e Dytë Botërore ka karakterin e një lufte civile, por nuk mund të mohojë që ka elemente të tilla. “Megjithatë nuk më duket e drejtë të quhet lufta e FNÇ me Ballin dhe Legalitetin luftë civile, ndonëse përmban elemente të kësaj lufte si në formë, ashtu dhe në përmbajtje”.⁸

Në vëllimin e tretë të tekstit “Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e Popullit Shqiptar (prill 1939-nëntor 1944)”, botuar më 1988 nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së, nuk përmendet termi “luftë civile”, por rikthehet te termi “luftë vëllavrasëse”, nxitëse e së cilës konsiderohet Balli Kombëtar dhe “zogistët”, për shkak të bashkëpunimit të tyre me pushtuesin. “Si pushtuesit gjermanë, ashtu dhe reaksioni i brendshëm shikonin te Fronti, Ushtria Nacionalçlirimtare dhe Partia Komuniste armikun kryesor” dhe, për shkak se, nuk mund t’u bënin ballë me forcat e veta, ata bashkuan forcat për të luftuar kundër tyre. Lufta argumentohet se kishte karakter klasor, e cila nga vjeshta e vitit 1943 kishte vënë përballë njëra-tjetrës “si asnjëherë tjetër, dy blloqe kundërshtarësh”: “popullin kryengritës” dhe “reaksionin”, i cili bashkëpunonte me pushtuesit nazistë dhe kishte edhe mbështetjen e anglo-amerikanëve. Në tekst nuk pranohet që kjo përplasje të kishte ndryshuar karakterin nacionalçlirimtar të luftës.⁹

Pas viteve ’90, ishte pikërisht Ndreçi Plasari, ndër të parët studiues, që ridimensionoi disa prej tezave të historiografisë shqiptare për Luftën e

⁸ Për më tepër shih: Ndreçi Plasari, “Bashkimi i popullit rreth PKSH në Frontin Nacionalçlirimtar”, në *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, vëll. 2, Tiranë: 8 Nëntori, 1975, f. 18.

⁹ *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar (prill 1939-nëntor 1944)*, vëll. III, botim i Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së, Tiranë: 8 Nëntori, 1988, f. 214-225.

Dytë Botërore. Në artikullin “Çështja kombëtare në programin e PKSHE dhe FNÇ në periudhën e Luftës së Dytë Botërore”, ai fajëson Enver Hoxhën dhe PKSHE-në për fillimin e luftës vëllavrasëse. Sipas tij, ishte çështja e pushtetit që çoi në denoncimin e Marrëveshjes së Mukjes dhe në përplasjen e dy grupimeve politike.¹⁰ Më pas shumë botime, kryesisht në lëmin e kujtimeve të ish-anëtarëve e drejtuesve të Ballit Kombëtar, iu rikthyen tezës së luftës civile¹¹, madje, ndonjë prej tyre, shkon edhe përtej, duke mohuar tërësisht karakterin nacionalçlirimtar të Luftës.

Në shkrimet akademike të pas viteve '90 janë elaboruar dy teza kryesore diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën. Njëra prej tyre është ajo që pohon vetëm karakterin nacionalçlirimtar të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri dhe nuk pranon në asnjë mënyrë ekzistencën e një konflikti apo lufte civile.¹² Argumentet që japin mbështetësit e kësaj teze

¹⁰ Ndreçi Plasari, “Çështja kombëtare në programin e PKSHE dhe FNÇ në periudhën e Luftës së Dytë Botërore”, në *Studime historike*, nr. 1-4, Tiranë: 1993, f. 136.

¹¹ Abas Ermenji, *Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë*, botimi II, Tiranë: Çabej, 1996, f. 498-516; Hasan Dosti, *Një jetë për çështjen shqiptare*, Tiranë: Botart, 2008; Faik Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1944)*, vëll. II, Tiranë: ILAR, 2006; f. 309-358; Ali Këlcyra, *Shënime për Historinë e Shqipërisë*, përgatiti për botim Tanush Frashëri, Tiranë: Onufri, 2012, f. 187-191.

¹² Në vitin 1992, studiuesi Xhemil Frashëri botoi në shtypin e përditshëm një artikull të gjatë me titull “LANÇ dhe legjenda e luftës civile”. Në të, ai kundërshtonte si tezat e historiografisë komuniste për ekzistencën e luftës së klasave gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, pasi asnjë nga problemet klasore nuk ishin shtruar për zgjidhje, ashtu edhe ekzistencën e luftës civile me argumentin se forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar bashkëpunuan me pushtuesin dhe lufta ka vetëm karakter nacionalçlirimtar. Ai pranonte ekzistencën e revolucionit popullor, i cili në këndvështrimin e tij kishte më shumë karakter antiimperialist sesa klasor, për shkak se në Lëvizjen Nacionalçlirimtare u përfshinë elementë nga të gjitha klasat e shoqërisë. (*Shih*: Xhemil Frashëri, *LANÇ dhe legjenda e luftës civile (Studime historike)*, Tiranë: Dardania, 2003). Studiuesi tjetër Xhelal Gjeçovi në monografinë *Shqipëria në pushtimin gjerman (1943-1944)*, nuk e trajton fare çështjen e luftës civile. Ai i konsideron nacionalistët shqiptarë pa dallim si bashkëpunëtorë të gjermanëve dhe me këtë argumenton karakterin vetëm nacionalçlirimtar të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Të njëjtin trajtesë mbi pushtimin gjerman të Shqipërisë gjejmë edhe në tekstin *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV (Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990), redaktor shkencor Xhelal Gjeçovi, Tiranë: Toena, 2009, f. 90-91. Historiani Marenglen Kasmi gjithashtu argumenton tezën e bashkëpunimit të nacionalistëve shqiptarë me pushtuesin gjerman që prej muajit shtator, duke shpjeguar arsyet e pushtuesve gjermanë për të përdorur forcat nacionaliste shqiptare në luftë kundër formacioneve komuniste, por pa përmendur çështjen e ekzistencës së luftës civile. *Shih*: Marenglen Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane të shek. XX*, Tiranë:

janë: prezenca e një ushtrie të huaj pushtuese në Shqipëri, rezistenca e Ushtrisë Nacionalçlirimtare ndaj pushtuesit dhe bashkëpunimi i Ballit Kombëtar me ta. Teza e dytë pranon karakterin e dyfishtë që mori Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri nga shtatori 1943-nëntor 1944, atë të rezistencës nacionalçlirimtare dhe të luftës/konfliktit civil.¹³ Argumenti që jep ky grup studiuesish lidhet me qëllimet e forcave ndërluftuese dhe mjetet që përdoren për të arritur këto qëllime. Për sa kohë që qëllimit fillestar që ishte rezistenca kundër pushtuesit i shtohet edhe lufta për marrjen e pushtetit, atëherë qartazi përcaktohet edhe karakteri i dyfishtë i Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Ka edhe studiues që, ndërsa pranojnë elemente të luftës civile, nuk e konsiderojnë atë si karakteristikë të kësaj periudhe historike. Raporti i pabarabartë i forcave ndërluftuese në luftën/konfliktin civil, sipas këtyre autorëve, nuk krijon bazën e duhur

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2020, f. 214-238. Profesor Paskal Milo ndonëse nuk e përmend termin luftë civile pranon se “në një analizë të drejtpeshuar të ngjarjeve e zhvillimeve politike të muajit shtator si dhe e dokumenteve që ekzistojnë rreth tyre ngarkon, në radhë të parë, me përgjegjësi Partinë Komuniste (për goditjen e Ballit Kombëtar – S.B.). Por nëse komunistët bënë hapin e parë të gabuar, ballistët bënë të dytin, shumë më të gabuar dhe me pasoja katastrofike për vetë Ballin e për vendin” (është fjala për qarkoren e 7 tetorit 1943 – S.B.). *Shih*: Paskal Milo, *Udhëkryqje shqiptaro-gjermane*, Tiranë: Toena, 2016, f. 115.

¹³ Shumica e studiuesve të huaj, që kanë shkruar për këtë periudhë të historisë së Shqipërisë, pranojnë karakterin e dyfishtë që mori Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri në këtë periudhë. *Shih*: Bernd J. Fischer, *Shqipëria në Luftë 1939-1945*, Tiranë: Çabej, 2000, f. 261-263; Roderick Bailey, *Lufta e Fshehtë në Shqipëri*, Tiranë: Naimi, 2019; Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur: Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993. Kjo tezë mbështetet edhe nga një pjesë e konsiderueshme e studiuesve shqiptarë, të cilët mbrojnë idenë e karakterit të dyfishtë të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri: nacionalçlirimtar dhe luftë civile. Studiuesja Ana Lalaj, pranon se pas mbledhjes së dështuar të Mukjes, Luftës së Dytë Botërore iu shtua edhe karakteri i luftës vëllavrasëse, apo civile, për të cilën ajo fajëson PKSH-në. *Shih*: Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Tiranë: Toena, 2014, f. 61; Studiuesi Romeo Gurakuqi fajëson PKSH-në për karakterin e luftës civile që mori Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri dhe, për shkak se bazohet kryesisht në dokumente britanike, daton muajin nëntor-dhjetor 1943 si fillimin zyrtar të saj. *Shih*: Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirue 1939-1946*, Tiranë: Jozef, 2018, f. 649-664. Uran Butka i ka dedikuar një monografi të gjerë karakterit civil të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Në parathënien e kësaj monografie ai pohon se ky është vetëm një aspekt i patrajtuar i historisë së Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, prandaj kërkon vëmendje më të madhe. Kjo nuk mohon, sipas tij, karakterin nacionalçlirimtar të Luftës për të cilin është shkruar shumë. *Shih*: Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1945*, Tiranë: Drier, 2006, f. 11-12.

për ta konsideruar luftën civile si një prej tipareve dalluese të kësaj periudhe.

Mendoj se karakteri i një ngjarjeje historike, në varësi të dinamikave që shfaqen në një periudhë të caktuar, mund të jetë i shumëfishtë. Studiuesi britanik, Eric Hobsbawm argumenton se qysh gjatë viteve '30 dhe, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore në Evropë ngjarjet morën edhe karakterin e një lufte civile ndërkombëtare, pasi "kundërshtitë midis forcave fashiste dhe antifashiste u bënë të brendshme në çdo shoqëri".¹⁴ Studiuesi francez Bernard Lory, duke analizuar Ballkanin gjatë Luftës së Dytë Botërore arrin në konkluzionin për karakterin e katërfishtë të ngjarjeve në këtë rajon të Evropës: çlirimtar, fetar, etnik, civil.¹⁵

Është qëllimi i personazheve dhe/apo forcave ndërvepruese dhe janë mjetet që ato zgjedhin të përdorin në arritjen e këtyre qëllimeve, ajo çka përcakton karakterin e ngjarjes historike. Për PKSH-në qëllimi final ishte pushteti politik i pasluftës, i cili do të sigurohej ndërmjet rezistencës së armatosur kundër pushtuesit, si një nga mënyrat kryesore për të fituar si mbështetjen e gjerë popullore, ashtu edhe besimin e Aleatëve të Kombeve të Bashkuara. PKSH-ja synonte një sistem politik njëpartiak, prandaj ajo vendosi që të mos ndante rezistencën në mënyrë që të mos ndante, më vonë, edhe pushtetin. Balli Kombëtar ishte krijuar si një organizatë republikane, antiitaliane, antikomuniste dhe nacionaliste. Sigurisht edhe ai kishte projektimet e tij për Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore dhe çështjen e pushtetit. Qëllimi i tij kryesor, në këtë fazë të luftës, ishte moslejimi i fuqizimit të PKSH-së, aq sa të mund të zotëronte e vetme shtetin shqiptar, si dhe zgjidhja e çështjes kombëtare, pra ruajtja e bashkimit kombëtar, të bërë nga pushtuesit italianë. Për arritjen e këtyre qëllimeve, drejtuesit e Ballit Kombëtar do të kërkonin dhe do të gjenin aleatë jokonvencionalë, të cilët, në analizë të fundit, u kthyen në *boomerang* për fatin e vetë organizatës.

¹⁴ Eric J. Hobsbawm, *Il secolo breve 1914-1991*, Settima edizione, Milano: BUR saggi/Rizzoli, 2016, f. 175.

¹⁵ Bernard Lory, *Evropa Ballkanike nga 1945 në Ditët e Sotme*, Tiranë: Dituria, 2007, f. 18.

Rezistencë dhe luftë civile: PKSH/LNÇ-së dhe Ballit Kombëtar gjatë muajve tetor-nëntor 1943

Pushtimi gjerman i Shqipërisë i gjeti marrëdhëniet midis PKSH/LNÇ-së dhe Ballit Kombëtar shumë të acaruar. Nga fundi i gushtit dhe gjatë muajit shtator 1943, lufta politike e kahershme mes dy organizatave ishte shoqëruar edhe me veprime luftarake reciproke, por këto të fundit më shumë kishin karakterin e atentateve që synonin eliminimin në mënyrë selektive të personave që konsideroheshin “reaksonarë të rrezikshëm”, sesa aksione në shkallë të gjerë. Përfundimisht bënte rajoni i Korçës, ku konflikti ndërmjet dy grupimeve politike kishte marrë përmasa më të gjera.¹⁶

Direktivat e KQ të PKSH-së, të cilat u ishin dërguar të gjitha strukturave të PKSH-së me qarkoren e 10 shtatorit 1943 dhe Rezolucioni i Konferencës II të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, duket sikur nuk kishin pasur efektin e dëshiruar te drejtuesit e lartë të PKSH-së. Disa prej këtyre komiteteve, siç ishte p.sh. rasti i komitetit qarkor të PKSH-së për Gjirokastrën, Beratit dhe Dibrën vijonin ende t’i mëshonin luftës propagandistike e politike ndaj Ballit Kombëtar¹⁷, madje edhe të nxisnin bashkëpunimin me nacionalistët.

¹⁶ Për më shumë mbi marrëdhëniet ndërmjet Ballit Kombëtar dhe PKSH/LNÇ-së gjatë muajit shtator shih: Sonila Boçi, “Partia Komuniste e Shqipërisë dhe Balli Kombëtar gjatë muajve gusht-shtator 1943”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 171-197.

¹⁷ Në shkurt 1943, komiteti qarkor i PKSH-së për Gjirokastrën ishte qortuar nga drejtuesit për sektarizëm, pasi kishin rrezikuar një konflikt të armatosur me një çetë të Ballit Kombëtar. Në një letër të gjatë, Enver Hoxha u shpjegonte se Balli duhej të luftohej politikisht dhe propagandistikisht, pasi ende nuk ishte koha për konflikt të armatosur. Edhe në qershor 1943, kur një skuadër partizane kishte arrestuar Ali Këlcyrën, KQ i PKSH-së kishte ndërhyrë për lirin e tij, duke i tërhequr sërish vëmendjen për ta mbajtur marrëdhënien me Ballin në kufijtë e një rivaliteti politik. Ishte ndoshta për këtë arsye që drejtuesit lokalë të PKSH-së për Gjirokastrën nuk iu përgjigjën menjëherë direktivave të 10 shtatorit 1943 dhe vijuan të bënin thirrje për demaskim politik e propagandistik të Ballit Kombëtar. Në një raport që Haki Toska i dërgon KQ të PKSH-së në fund të shtatorit 1943 ai sërish i mëshon idesë së luftës politike: “Qëndrimi jonë me Ballin duhet të jetë po i pari. Jo bashkim për bashkim se kështu i bëmë varrin bashkimit, por bashkim me baza të shëndosha d.m.th të bëjnë një rishikim të politikës së tyre, mbasi të dënojnë politikën e tyre të mëparshme të gabuar dhe mbasi të hyjnë në luftë”. Për më tepër *shih*: Sonila Boçi, “Grupimet politike

Enver Hoxha e pa të nevojshme të sqaronte edhe një herë më në detaje ndryshimin në vijën politike të PKSH-së dhe LNC-së pas Konferencës së Dytë të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (4-8 shtator 1943). Më 1 tetor 1943 ai dërgoi dy letra: njëra prej tyre i drejtohej Liri Gegës, drejtueses politike të komitetit qarkor të PKSH-së për Vlorën dhe për veprim të gjithë komiteteve qarkore të PKSH-së¹⁸, ndërsa tjetra, drejtuesve të komitetit qarkor të Gjirokastrës. Të dy dokumentet shënojnë një moment kthese në fatet e LDB në Shqipëri, pasi së bashku me qarkoret e Ballit Kombëtar të 7 tetorit 1943, shënojnë zyrtarizim të konfliktit të armatosur midis dy grupimeve politike. Ato shpalosin qëllimet jo vetëm imediate, por edhe afatgjata të PKSH-së, si dhe ravijëzimin e linjave politike *vis-a-vis* kundërshtarëve, të cilat do të shërbejnë edhe më pas për të nxitur luftën e klasave dhe portretizuar “armikun e popullit”. Si të tilla, meritojnë një analizë të thelluar.

Qëllimi i parë që theksonte letra ishte ai i përgatitjes së kushteve për krijimin e një shteti njëpartiak, zotëruesi i pushtetit të të cilit do të ishte PKSH-ja. Në këtë fazë, ky pushtet do të ushtrohej me anë të këshillave nacionalçlirimtare të kontrolluara nga komunistët. “Në radhë të parë na paraqitet çështja e pushtetit, - porosiste kreu i PKSH-së, Enver Hoxha në të dy letrat, - dua të them vendosja kudo e këshillave nacionalçlirimtare, forcimi i tyre dhe mbrojtja e tyre nga ç’do tentativë e Ballit ose e ndonjë partije tjetër që do të përpiqet ta sabotojë ose ta luftojë haptazi. Për këtë punë nuk duhet të ketë dy kuptime: vetëm pushteti i këshillave duhet të egzistojë dhe as një pushtet tjetër, nuk ka kompromis dhe dualitet në këtë gjë”¹⁹.

jofashiste në Shqipëri në pranverën e vitit 1943”, në *Studime historike*, nr. 3-4, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2015, f. 137-162.

¹⁸ Letra në fjalë gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit në dy kopje të ndryshme me këto referenca: *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39. Letër e Enver Hoxhës drejtuar Liri Gegës (Muzhikut) dhe për veprim të gjithë komiteteve qarkore të PKSH, 1 tetor 1943 dhe *po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3-5. Letër e Enver Hoxhës drejtuar Muzhikut (Liri Gegës), 1 tetor 1943. Të dy dokumentet janë kopje të daktilografuara. Në dokumentin e parë janë bërë disa ndryshime, të cilat lidhen kryesisht me marrëdhëniet e Enver Hoxhës me Liri Gegën. Kopja që gjendet në dosjen 11 është botuar më pas në: *Dokumente kryesore të Partisë së Punës së Shqipërisë*, vëll. I, përgatitur për botim nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së, Tiranë: 8 Nëntori, 1971, f. 204-209.

¹⁹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39. Letër e Enver Hoxhës drejtuar komiteteve qarkore të PKSH, 1 tetor 1943.

Letra u kujtonte drejtuesve komunistë lokalë parimin e rëndësishëm leninist, atë të marrjes me dhunë të pushtetit. Përdorimi i shprehjeve të tilla “me i ranë kokës partisë zogiste” “t’i zhdukim ato plehëra”²⁰ ishin tregues të frymës së përgjithshme, të krijimit të një mentaliteti përjashtues të reflektuar në dy grupe të ndara qartazi në “ne” dhe “ata”. Për sa kohë që përparësi kishte marrë çështja e pushtetit dhe marrja e tij vetëm nga PKSH dhe UNÇ, kundërshtarët politikë ose duhet të absorboheshin në Lëvizjen Nacionalçlirimtare ose të eliminoheshin. Procesi duhet të niste me Ballin Kombëtar, si organizata më e fuqishme, pasi “Balli nuk ta lëron (lëshon – S.B.) pushtetin dhe as kush tjetër në qoftë se nuk e rrëmben me forcë pse është e drejta tënde dhe e popullit”.²¹

Që goditja të ishte e efektshme, kundërshtari politik duhej të vizatohej si “armik” që duhej eliminuar. Populli duhej të bënte një ndarje të prerë midis “neve” dhe “atyre”. “Ne” ishin të gjithë shqiptarët që kishin pranuar të përqafonin idenë e frontit nacionalçlirimtar dhe ishin përfshirë në rezistencë kundër pushtuesit. “Ata” ishin të gjithë të tjerët, pavarësisht nëse kishin pranuar të ishin në administratën e pushtuesit, të luftonin kundër tij në siglën e një grupi tjetër politik, apo qoftë edhe indiferentët. Koncepti “o me ne, o kundra nesh”, që u bë themel i politikës së PKSH-së, shpjegohet në mënyrë të detajuar në këto letra. Drejtuesit më të lartë komunistë ishin të vendosur të mos lejonin të vepronte asnjë grupim politik a ushtarak të cilin nuk mund ta kontrollonin. Për këtë arsye kërkonin që rezistenca të bëhej vetëm në siglën e Frontit. “Këjo parti, - shkruante E. Hoxha, duke iu referuar Partisë Nacional Zogiste, trakti i partisë me këtë emër ishte shpërndarë vetëm tri ditë më parë, - doli dhe vepron jashtë frontit nacional çlirimtar dhe ç’do parti e tillë o ç’do grumbullim ushtarësh jashtë frontit nacional çlirimtar dhe Ushtëris Nacional çlirimtare duhet të lëftohen si parti që bën lodrën e armikut dhe si një ushtëri bashibozuke që përpiqen të sjellin ditët e zeza për popullin dhe të vendosin në vendin tonë regjime të klikave dhe të personave”.²² Në këtë konstatim nuk ka referime për ndonjë bashkëpunimi të drejtpërdrejtë, deri në atë moment, të këtyre grupimeve

²⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Liri Gegën (Muzhiku), 1 tetor 1943.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39. Letër e Enver Hoxhës drejtuar komiteteve qarkore të PKSH, 1 tetor 1943; *po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Liri Gegën (Muzhiku), 1 tetor 1943.

me pushtuesit. Frika qëndronte te supozimi që këto parti, duke kundërshtuar PKSH/LNÇ mund të bënin “lojën e okupatorit”, por, mbi të gjitha, në sigurimin e krediteve e nevojshme për marrjen e pushtetit të pasluftës. Duke qenë se Balli Kombëtar ishte një grupim më i konsoliduar dhe pa të kaluarën politike të zogistëve²³, ishte ai që duhej eliminuar fillimisht, ndërsa demaskimi i partisë të re duhet të bëhej progresivisht, pasi “shpejt do të kemi rastin që t’ja heqim fare petën byreku”.²⁴

Etiketimi i kundërshtarit politik si armik ishte vetëm pikënisja e procesit, pasi më e rëndësishmja ishte që ai të projektohej si i tillë në masat e gjëra të popullsisë. Në procesin e portretizimit të kundërshtarit si “armik i popullit” propaganda kishte një vend parësor dhe letrat na japin një tablo të procesit të shndërrimit të një organizate nga kundërshtarë politike në “tradhtarë të atdheut”. Të dy letrat e sipërcituara jepnin këshilla për sedertimin e propagandës i cili në këtë fazë kishte një qëllim: “demaskimi” politik duhej t’i paraprinte goditjes me armë. Propaganda duhej të bëhej në mënyrë të diferencuar duke pasur parasysh ato të vërteta apo gjysmë të vërteta, të cilat do të bënin më shumë efekt në një krahinë apo rajon të caktuar. Në letrën dërguar Liri Gegës propozohej që Balli të demaskohej si një organizatë që “bën lojën e okupatorit dhe tok me të të

²³ Për drejtuesit e lartë të PKSH-së, krijimi i një partie që synonte kthimin e Mbretit Zog në Shqipëri ishte në favor të PKSH-së, sepse kjo do të ndikonte në përçarjen e forcave antikomuniste, të cilat, në të vërtetë, kishin filluar të bashkoheshin pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes. “Ky trakt, - shkruante Hoxha, - vjen në një moment kur reaksioni po grumbullonte gjithë forcat e tij në Ballin Kombëtar për të na lëftuar më mirë neve dhe lëvizjen nacional-çlirimtare. Me daljen e këtij trakti shumë vetve ju shkojnë të ngjetha në trup dhe fillojnë të mendojnë seriozisht për rrezikun e Zogut që lufta kundra nesh jau kish haruar për një moment”. Për këtë arsye, Hoxha porosiste që edhe kjo organizatë të demaskohej si një parti jashtë Frontit Nacionalçlirimtar. Qartazi Hoxha druhej të hapte një front të ri luftime, prandaj porosiste “Në demaskimin e kësaj partije duhet të kemi kujdes që të mos të bëjmë gabimin që mund të ketë ngrehur okupatori dua të them që ky demaskim të mos bjerë si bombë në mënyrë që gjithë lufta e jonë dhe kujdesi i popullit të drejtohet vetëm kundra rrezikut Zogist dhe të harojmë objektivin kryesor që është lufta kundër okupatorit”. *Shih: Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39. Letër e Enver Hoxhës drejtuar komiteteve qarkore të PKSH, 1 tetor 1943; *po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Liri Gegën (Muzhiku), 1 tetor 1943.

²⁴ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 35-39. Letër e Enver Hoxhës drejtuar komiteteve qarkore të PKSH, 1 tetor 1943; *po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Liri Gegën (Muzhiku), 1 tetor 1943.

demaskohen të gjithë krerët sidomos ata të zonës tuaj”.²⁵ Në letrën drejtuar Gjirokastrës, kërkohet të akuzoheshin krerët e Ballit si kompromisaxhinj “që s’kanë hedhur një pushkë kundër fashizmit dhe vazhdon të mos hedhë asnjë kundër gjermanëve, por që e ndihmon këtë për të na vrarë”.²⁶

Për popullin e Gjirokastrës ishte e njohur se një pjesë e çetave balliste, si ajo e Nexho Bejlerit kishte bashkëpunuar edhe me pushtuesit italianë kundër forcave të LNÇ duke shkaktuar një masakër të vërtetë në popullsinë e Libohovës, po kështu ishte i njohur edhe protokollin i nderit ndërmjet Ali Këlcyrës me gjeneralin italian Lorenzo (Renzo) Dalmazzo. Kjo sigurisht nuk ishte një situatë e përgjithshme, por duke manipuluar me këto të vërteta, komunistët e rajonit të Gjirokastrës do ta kishin më të lehtë të bindnin njerëzit për “karakterin reaksionar dhe tradhëtinë” e Ballit Kombëtar.

Në Vlorë, situata ishte disi më ndryshe. Shumë prej çetave të Ballit kishin luftuar kundër pushtuesve italianë, në disa raste së bashku me çetat partizane. Vetëm tri ditë më parë, Liri Gega, në një letër që i shkruante Enver Hoxhës, njoftonte për një përplasje midis forcave balliste të drejtuara nga Aziz Çami dhe atyre gjermane.²⁷ Populli gjithashtu e kishte parë përpjekjen e çetave të Ballit për të marrë pjesë në luftën e Drashovicës kundër gjermanëve.²⁸ Në këtë rast, duheshin “gjetur fakte” për të dëshmuar tradhtinë e Ballit.

Ndërsa qëllimi ishte eliminimi ushtarak i Ballit Kombëtar, duket sikur ndërmjet drejtuesve të lartë të PKSH-së nuk ka mendim të unifikuar

²⁵ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Liri Gegën (Muzhiku), 1 tetor 1943.

²⁶ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 39-42. Letër e Enver Hoxhës drejtuar komitetit qarkor të PKSH-së për Gjirokastrën, 1 tetor 1943.

²⁷ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 2. Letër e Liri Gegës (Muzhiku) drejtuar Enver Hoxhës, 27 shtator 1943.

²⁸ Në një raport të komitetit qarkor të PKSH-së për Vlorën dëshmohet se forcat e Ballit nuk ishin lejuar të merrnin pjesë në luftën e Drashovicës kundër pushtuesve gjermanë. “Lufta e Drashovicës dhe përpjekjet e tjera që ne patëm me Gjermanët hodhën posht të gjitha pallavrat e Ballistavet dhe e nxuarmë lakuriq para popullit ashtu si kemi thënë nevet. Nga ana tjetër Ballistat duke parë këtë gjendje deshën të paraqiteshin popullit si luftëtarë dhe dërguan atje ku ishim nevet një çetë prej 70 vetash. Ne duke kuptuar këtë gjë nuk i pranuan në luftë, gjatë kësaj kohe ne nuk kemi ndenjur së demaskuari me anë traktesh dhe komunikatash qëndrimin e Ballit, formimin e komisioneve në Vlorë në marrëveshje me gjermanët etj”. *Shih: Po aty*, F. 18/APL, V. 1943, D. 4, fl. 3. Raport i komitetit qarkor të PKSH për Vlorën drejtuar KQ të PKSH, pa datë.

sesi do të realizohej ai. Nako Spiru, një prej anëtarëve të KQ të PKSH-së dhe drejtuesi i Rinisë Komuniste, propozonte ndërmarrjen e menjëhershme të një operacioni të përgjithshëm ushtarak kundër Ballit Kombëtar. Spiru gjykonte se momenti ishte shumë i përshtatshëm për sa kohë pushtuesit gjermanë ende nuk i kishin konsoliduar institucionet nën kontrollin e tyre.²⁹ Në të kundërt, Hoxha propozonte një strategji të bazuar në një aksion të diferencuar duke mbajtur parasysh raportet e forcave në çdo rajon e krahinë. Këtë e parashtronte si në letrën dërguar Liri Gegës, ku shprehet se, në “rast se ushtarakisht s’jeni në gjendje [Ballin] duhet ta goditni politikisht por s’duhet të harroni as një moment me pregatit grushtin që duhet t’i jepni ushtarakisht. S’ka rrugë tjetër”³⁰, ashtu dhe në letërkëmbimin me Ymer Dishnicën dhe Nako Spirun ku pohon se “Natyrisht në ato raste kur çetat e Ballit po tronditen si për shëmbëll në Korçë, ahëre çetat tona duhet t’i likuidojnë dhe t’i goditin”.³¹

Enver Hoxha dëshmohej si një njohës i mirë i realitetit brenda strukturave të PKSH-së dhe UNÇ-së, i raportit të forcave ndërluftuese dhe mjaft i qartë në qëllimet afatgjata. Premisë e nevojshme që goditja ushtarake ndaj Ballit Kombëtar të kishte efekt ishte minimizimi i influencës politike dhe reputacionit që një pjesë e madhe e drejtuesve të organizatës kishin në popull. Nga ana tjetër, LNÇ ishte krijuar si një lëvizje rezistence antifashiste dhe nacionalçlirimtare, në të cilën ishin bashkuar shumë shqiptarë, që nuk ishin komunistë. Vijimi i rezistencës edhe kundër pushtuesve gjermanë ishte gjithashtu premisë e domosdoshme për të fituar mbështetjen e gjerë popullore. Këtë të fundit kishte parasysh Enver Hoxha kur u shpjegonte kolegëve të vet se “Për çështjen e ofensivës së përgjithëshme kundra Ballit, ne mendojmë që këjo ofensivë të mos jepet në atë mënyrë që e kuptoni ju pse s’jemi hala aq të fortë sa t’u hapim luftë gjithë çetave të Ballit në Shqipëri dhe njëkohësisht me godit dhe okupatorin”³².

Për arritjen e këtyre dy detyrave, që për PKSH-në ishin njëlloj të rëndësishme, ajo krijoi një strategji që rezultoi e suksesshme. Pjesa më e

²⁹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 21, fl. 31-33. Letër e Ymer Dishnicës dhe Nako Spirut për Enver Hoxhën, 1 tetor 1943.

³⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 22, fl. 3. Letër e Enver Hoxhës për Liri Gegën (Muzhiku), 1 tetor 1943.

³¹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 8-10. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun dhe Dishnicën, 4 tetor 1943.

³² *Po aty*.

madhe e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar u shpërndanë nëpër rajone të ndryshme të Shqipërisë për të ndihmuar në ngritjen e këshillave nacionalçlirimtarë. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ lëshoi një sërë urdhrash për forcimin dhe disiplinimin e ushtrisë partizane. Tanimë forcat e UNÇ-së kishin siguruar një sasi jo të vogël material nga ushtria e kapitulluar italiane, si dhe kishin marrë premtimin e misionëve britanike për ndihma financiare dhe ushtarake. Pas Brigadës I, të inauguruar në gusht 1943, filloi përgatitja për krijimin e tri brigadave të tjera: një në zonën e Elbasani (Brigada II), një në Tiranë (Brigada III), si dhe po përgatitej krijimi i një brigade në zonën e Korçës. Komitetete qarkore të Tiranës, Beratit, Gjirokastrës dhe Vlorës iu dërguan urdhra për të nxjerrë vullnetarë për këto brigada.³³ Drejtuesit e lartë të PKSH-së u treguan të kujdesshëm që rezistenca, qoftë edhe demonstrative, kundra ushtrisë gjermane, të mos ndalonte.³⁴ Në disa rajone si në Berat, ku kishte ndodhur një kompromis midis drejtuesve lokalë të PKSH/LNÇ-së të drejtuar nga Gjin Marku dhe ushtrisë gjermane, apo në Korçë, ku sipas një informacioni të Koçi Xoxes nuk po sulmohej ushtria gjermane, pasi forcat ishin përqendruar tërësisht në luftën kundër Ballit, iu dërguan urdhra për të rifilluar operacionet kundër gjermanëve. “Informohemi nga fjalë populli, - shkruhej në një urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së, - se në Berat dhe Lushnje hyjnë lirisht gjermanët, gjoja me leje. Nëse kjo është e vërtetë, menjëherë duhet të ndalohet dhe kudo që shifen forca gjermane të qëllohen”.³⁵

Balli Kombëtar, si gjatë muajit shtator, edhe në vijim u tregua i pafuqishëm për të përballuar sulmet e forcave të UNÇ-së. Shkak për këtë ishte mungesa e organizimit të strukturave ushtarake dhe disiplinimi i tyre. Sipas dëshmive të vetë drejtuesve të Ballit, kontradiktat e brendshme e dobësuan edhe më shumë organizatën. Ndërsa, PKSH-ja dhe strukturat e saj politike dhe ushtarake kishin vendimmarrje të centralizuar dhe disiplinë dragoniane (çdokush që thyente urdhrat dënohej rëndë deri në pushkatim), Ballin e gërryen grupimet e ndryshme.

³³ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 27, fl. 4/1. Letër e Enver Hoxhës për Gogo Nushin, 14 tetor 1943.

³⁴ Për një informacion të detajuar mbi betejat e UNÇ kundër pushtuesve gjermanë gjatë muajit tetor 1943, *shih: Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ...*, f. 165-214.

³⁵ *AQSH*, F. 41/APL, V. 1943. D. 4, fl. 8. Letër e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ drejtuar komandës së Grupit, Berat, komandës së batalionit të Lushnjës, 5 tetor 1943.

Abaz Ermenji p.sh. nuk njihte autoritetin e Kadri Cakranit, si komandant të Ballit për krahinat e Jugut.³⁶ Në këto kushte, Balli u përfshi në sulme hakmarrëse pa ndonjë strategji të qartë. Pas vrasjes së Hazis Sharrës, anëtarit të Ballit në Vlorë dhe kumatit të Skënder Muços, Balli ekzekutoi tre persona, vetëm njëri prej të cilëve mendohej se kishte lidhje me ngjarjen. Komandanti krahinor i Ballit, Azis Çami shpalli me anë të një trakti se “megjithëse ishin vendosur të vrisnin 10 vetë, kësaj herë u mjaftuen vetëm me tre”.³⁷ Aktet e hakmarrjes vërtetohen edhe nga një trakt i Ballit Kombëtar sipas të cilit meqë “terrori i Partisë Komuniste kaloi kufit e durimit. Për këtë arsye organizata e jonë ka pak javë vendosi të marrë hakën e antarve të saj të vrarë prej komunistave. Në Vlorë për vrasjen e nacionalistit Aziz Shara, organizata vrau pesë pjestar të Nacional-Çlirimtares. Në Mallakastër për vrasjen e Qazim Hekalit me të birin, organizata e jonë ekzekutoi në Hekal 10 pjestar të Nacional-Çlirimtares, dhe për vrasjen e Idriz Drizdarit ekzekutoi në Drizdar 7 veta. [nënvizimet në dokument – S.B.]”.³⁸ Po kështu, një zinxhir i gjatë sulmesh hakmarrëse vijuan në Korçë, Berat, Tiranë etj., pjesa më e madhe e të cilave pa një efekt të rëndësishëm ushtarak dhe politik.

Ndërsa në aksionin ushtarak dhe politik, Balli nuk kishte suksesin e duhur, lufta propagandistike e tij u organizua mjaft mirë dhe kjo, sipas kujtimeve të F. Qukut, i dedikohet më së shumti punës dhe penës së Nexhat Peshkëpisë.³⁹ Në ligjërimin publik të Ballit Kombëtar në këtë periudhë vihet re një ndryshim drastik në krahasim me periudhën para Mbledhjes së Mukjes. Retorika kundër PKSH-së dhe rrezikut që komunistët paraqisnin për Shqipërinë dhe çështjen kombëtare u ashpërsua shumë. Në to i mëshohej lidhjeve ideologjike të komunistëve shqiptarë me ata sllavë dhe grekë në dëm të interesave kombëtare shqiptare; shpesh evokohen betejat e ndërmarra nga Balli kundër pushtuesve italianë, tanimë të mohuara nga propaganda e PKSH-së; përforcohet ligjërimi nacionalist duke vendosur në plan të parë nevojën e ruajtjes së bashkimit të territoreve shqiptare dhe, ndërsa nuk mungojnë deklarata për besnikërinë e Ballit Kombëtar ndaj çështjes aleate, referimet për nxitjen e rezistencës kundër kundër pushtuesve gjermanë bëhen gjithnjë e më të pakta, derisa mungojnë fare.

³⁶ F. Quku, *Qëndresa shqiptare ...*, f. 316.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11. Trakt i Ballit Kombëtar me titull “Dëshmorët”.

³⁹ F. Quku, *Qëndresa shqiptare ...*, f. 315.

Ligjërimi publik u mbështet edhe me aksione politike. Më 7 tetor 1943, Mit'hat Frashëri iu dërgoi strukturave të Ballit dy qarkore. Në qarkoren nr. 6 thuhej se “Me qënë se vendi ynë ka nevojë të ngutëshme për rregull dhe disiplinë, gjithë komitetet, komandat dhe çetat e Ballit Kombëtar porositen që me të arrijtur kjo qarkore të pezullohet çdo operacion luftarak kundër forcave gjermane tash për tash. Ma vonë do të dërgohen direktiva të tjera”.⁴⁰ Ndërsa në qarkoren nr. 7, pasi pohonte dëshirën e Ballit Kombëtar për t’iu larguar grindjes dhe gjakderdhjes me Partinë Komuniste (sic) dhe duke parë se strukturat e Ballit janë në sulm si propagandistik, ashtu edhe ushtarak, porosit që “çdo sulmi dhe çdo atentati komunist t’i përgjigjemi me një herë dhe po me atë mënyrë. Për këtë çashtje duhet bamë edhe një propagandë sistematike tue botue trakte, kështu që t’a kuptojë populli si asht e vërteta dhe kush e ka fajin”.⁴¹ Organizata e Ballit Kombëtar përcaktoi me këto dy dokumente antikomunizmin si prioritetin e saj duke iu përkushtuar tërësisht luftës civile dhe duke hequr dorë nga rezistenca kundër pushtuesve.

Për fat të keq, në një analizë më afatgjatë, ky vendim nuk rezultoi pozitiv as për vetë organizatën dhe as për Shqipërinë. Përqendrimi i forcave në luftë kundër UNÇ nuk ndikoi në kohezionin e brendshëm të saj. Ali Këlcyra, njëri prej anëtarëve të KQ të Ballit Kombëtar, krijoi në Kapinovë të Beratit një komitet për krahinat e Jugut, duke krijuar një lloj autonomie nga drejtuesit e tjerë të Ballit. Anëtari tjetër i KQ të Ballit, Kolë Tromara ishte i rrethuar në Korçë nga forcat partizane, pa kontakte me kolegët e vet.⁴² Një pjesë e të rinjve të Ballit ishin të shqetësuar për mungesën e aksioneve kundër gjermanëve dhe u përpoqën ose të krijonin komitete autonome, siç ishte rasti i Tiranës dhe Shkodrës, ose të krijonin grupime të tjera politike (në formë partish)⁴³, siç ishte krijimi i Partisë Socialdemokrate.⁴⁴

Pas 8 tetorit 1943, në të gjitha qarqet kryesore të Shqipërisë, si dhe në Dibër pati luftime të ashpra midis njësive të UNÇ-së dhe çetave të

⁴⁰ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 1, fl. 6. Qarkore nr. 6 e Mit'hat Frashërit drejtuar komiteteve krahinore të Ballit Kombëtar, 7 tetor 1943.

⁴¹ *Po aty*, fl. 7. Qarkore nr. 7 e Mit'hat Frashërit drejtuar komiteteve krahinore të Ballit Kombëtar, 7 tetor 1943.

⁴² F. Quku, *Qëndresa shqiptare ...*, f. 360.

⁴³ *Po aty*, f. 361-362.

⁴⁴ *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 4-7. Letër e Nako Spirut drejtuar Enver Hoxhës, 8 tetor 1943.

Ballit Kombëtar, por edhe krerëve nacionalistë të Dibrës, pjesa më e madhe e të cilave rezultuan të pasuksesshme për nacionalistët.⁴⁵ Të ndodhur në këtë presion një pjesë e nacionalistëve vendosën të pranojnë ofertën e komandës gjermane për t'i pajisur me armë, në mënyrë që t'i përdornin ato në luftë kundër komunistëve. Në informacionet e strukturave partiake dhe ushtarake të PKSH-së gjithnjë e më shumë shtohen informacionet mbi bashkëpunim të çetave të Ballit me pushtuesit gjermanë. Naxhije Dume, sekretarja e komitetit qarkor të PKSH-së për Korçën, njoftonte se tanimë Balli Kombëtar është hedhur “në luftë të hapur me ne e në bashkëpunim pa ndrojtje me okupatorin”. Sipas saj, ushtria gjermane së bashku me forcat e Ballit kanë djegur fshatra dhe kanë pushkatuar njerëz. “Brenda një muaji, - thuhet në raport, - janë djegur fshatrat më të mira Voskop-Gjonmadh-Lavdar-Polenë-Goskovë lart e poshtë-Ravonik-Çiflig-Selenicë e Pishës e ca të tjerë në Kolonjë. Janë pushkatuar 36 në Voskop, 10 Polenë, 30 Ravonik, 50 Çiflig – 16 Korçë”. N. Dume e konsideronte këtë një taktikë të pushtuesit për të ulur mbështetjen popullore ndaj LNC-së. “Taktika e okupatorit në qarkun t'onë asht t'a godasë popullin, t'a plaçkitij, t'a djegë, t'a terrorizojë që të na lërë ne si peshkun pa ujë e pastaj të na lëshojë Ballin Kombëtar që po e armatos e po e stërvit me aqë kujdes”.⁴⁶

Informacione të ngjashme vinin edhe nga Vlora, kur sipas raportit të komitetit qarkor të PKSH-së atje “fundi i luftës së Drashovicës (2 tetor 1943 - S.B.) i gjeti çetat e Ballit po thua të gjithë në Vlorë ku të bashkuar me gjermanët bëjnë roje qytetit”. Flitej madje për bashkëbisedime të Azis Çamit me oficerë gjermanë për të krijuar “një milici balliste që të jetë në qytet nënë urdhërat e Gestapos”. Raporti, madje fajësonte ballistët për bashkëpunim me gjermanët në reprezaljet që pushtuesit kishin bërë në qytetin e Vlorës. “Javën e kaluar ballistat e Vlorës bashkë me gjermanët bënë një pastrim të gjerë në popullin e Vlorës. Këta e bënë këtë gjë për t'u hakmarrë për vrasjen e një ballisti Hazis Sharra, vrasje që ne e bëmë për arësye gangsterizmi. Janë arrestuar 150 vetë në Vlorë nga të cilët 64 u internuan dhe pjesa tjetër u lirua me që s'njifej si e frontit dhe me që disa

⁴⁵ Mbi veprimet ushtarake midis forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Ballit Kombëtar *shih*: U. Butka, *Lufta civile ...*, f. 193-220; F. Quku, *Qëndresa shqiptare ...*, f. 309-357.

⁴⁶ *AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 31, fl. 2. Raport i Naxhije Dumes (Fortuna) drejtuar KQ të PKSH-së, pa datë.

prej tyre ishin Ballista”.⁴⁷ E njëjta panoramë bashkëpunimi vizatohej edhe për Berat, Fierin dhe Lushnjën. Tefik Sferi, Hajdar Cakrani dhe Eqrem Peshkëpia akuzohen si bashkëpunëtorë të pushtuesve, sepse kishin pranuar poste në administratën lokale si kryetar bashkie, apo nënprefektë. Çetat e Ballit Kombëtar akuzohen si bashkëpunëtorë edhe në reprezaljet e bëra në Libofshë dhe në Myzeqe. Gjatë betejës së forcave partizane me gjermanët në Patos ishte provuar, sipas këtij raporti, “se pararoja e tyre ishte nga ato të Tefikut dhe të Hajdarit”, po kështu, ndërsa luftohej me Ballin në Sheqës dhe Lapardha “mortajat gjermane nuk kanë pushuar së rrahuri partizanët”.⁴⁸ Gjini Marku shkante edhe më tej duke akuzuar pjesën më të madhe të krerëve qendrorë e lokalë të Ballit për bashkëpunim me pushtuesin gjerman. “E përsërisim se Balli me eksponentat Ali Këlcyra, Abaz Ermenji, Koço Muka, Xhevat Kallajxhi, Ethem Haxhiademi, Veli Zlausha, Faslli Frashëri, Mahmut Golemi, Mithat Aranitasi, Muharem Kapllani, Petrit Shahini etj, duhet të ketë vendosë jo vetëm me u përforcue para nesh, por edhe të na sulmojë, në bashkëpunim me gjermanët për me qenë i shëndoshë me zbritjen e Aleatëve në Shqipëri”.⁴⁹

Sa i takon bashkëpunimit të Ballit Kombëtar me gjermanët, të rrallë janë studiuesit që e mohojnë⁵⁰, por, kur filloi realisht ky bashkëpunim dhe se në çfarë niveli ka qenë ai gjatë muajve të parë të pushtimit gjerman të Shqipërisë është e vështirë të përcaktohet, pasi edhe dokumentacioni krijon një lloj konfuzioni. Është e qartë që pushtuesit gjermanë nuk vendosën forca të shumta ushtarake në Shqipëri dhe

⁴⁷ *Po aty*, F. 18/APL, V. 1943, D. 4, fl. 3. Raport i komitetit qarkor të PKSH për Vlorën drejtuar KQ të PKSH, pa datë.

⁴⁸ *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 31, fl. 10. Letër e Malësorit (Gjin Markut) për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 24 tetor 1943.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ Studiuesi Uran Butka nuk pranon hapur bashkëpunimin e Ballit Kombëtar me gjermanët. Ai përligj faktin se operacionet ndëshkimore gjermane të nëntor-dhjetorit 1943 drejtoheshin kryesisht kundër forcave të UNÇ, “jo vetëm se konsideroheshin forca komuniste nga Wehrmacht-i, por edhe pse ishin më aktive kundër tyre. Balli Kombëtar i kishte ndërprerë hë për hë luftimet kundër gjermanëve për shkak se ishte vënë mes dy zjarreve”. Gjithsesi ai pohon gjithashtu se nacionalistët e Ballit Kombëtar “i përdorën trupat gjermane gjatë Operacionit të Dimrit për të goditur forcat nacionalçlirimtare. Kështu që në disa zona e në disa luftime bashkë me gjermanët kanë marrë pjesë në luftime kundër forcave nacionalçlirimtare edhe persona, edhe pjesë të shkëputura, edhe mbeturina të xhandarëve, ballistëve e zogistëve në atë situatë anarkie dhe lufte civile”. Për më tepër shih: U. Butka, *Lufta Civile ...*, f. 270.

shpresonin që këtë zonë ta mbanin nën kontroll duke përdorur forcat shqiptare.⁵¹ Gjatë muajve tetor-nëntor, propaganda e Ballit Kombëtar ka mohuar çdo lloj bashkëpunimi me pushtuesit gjermanë dhe ende jepte mesazhe besnikërie ndaj kauzës së Aleatëve të Kombeve të Bashkuara.⁵² Dokumentacioni gjerman flet për nacionalistë shqiptarë dhe rrallë bën diferencime midis Ballit Kombëtar dhe elementëve apo grupimeve të tjera, të cilat vepronin jashtë tij. Me apo pa dashje këtë ngatërresë e bënin shpesh edhe drejtuesit lokalë të PKS-së duke konsideruar si ballistë, madje edhe strukturat ushtarake të qeverisë shqiptare gjatë pushtimit gjerman. Informacionet e dhëna nga strukturat vendore të PKS/LNÇ duhen marrë me rezerva, pasi në disa raste ka edhe ekzagjerime, të cilat bëheshin për të justifikuar luftën e filluar ndaj Ballit Kombëtar. Kështu, p.sh. për implikimin e Ballit në arrestimet dhe internimet e banorëve të Vlorës, numri i të cilëve, sipas dokumentit që gjendet në Arkivin e Shtetit, është 106 vetë⁵³, kundërshtohet nga dy burime të ndryshme. *I pari*, është një trakt i Ballit Kombëtar, i cili mohon përfshirjen e anëtarëve të Ballit Kombëtar në ngjarjen e 8 tetorit në Vlorë, madje duke theksuar se “E vërteta asht: Gjermanët jo vetëm qi nuk bânë asnji dallim, por damin mâ të madh në këtë mes e pati vetë Balli, sepse materiali ushtarak dhe landa ushqimore qi u kap prej gjermanve ka qenë mâ e shumta e Ballit, pa marrë parasysh se midis 104 të rreshtuemve, përveç 3 o 4 komunistash, mâ të shumtit kanë qenë të Ballit dhe kusuri asnjans”.⁵⁴ Burimi i dytë është një raport i hartuar nga komanda gjermane e qytetit të Vlorës, i cili ia ngarkon përgjegjësinë e hartimit të listave të komunistëve dhe mbështetësve të tyre në qytet, jo Ballit Kombëtar, por prefektit të Vlorës, Vizhdan Risilisë.⁵⁵

Nga kryqëzimi i kujdesshëm i dokumenteve, mund të thuhet se, veçanërisht në gjysmën e dytë të muajit tetor ka indikacione të besueshme

⁵¹ M. Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane...*, f. 314-315.

⁵² Në një prej trakteve të Ballit Kombëtar të afishuara në tetor 1943 thuhej ndër të tjera: “Neve po lëftojmë, e kemi thënë gjithmonë, për bri aleatvet t’onë të mëdhej, dhe kemi admirimin më të math për ushtrinë Kombëtare Ruse gëzohemi shumë që u çlirua Smolensku, por si do që të jetë, Atdheu asht atdhe Aleati Aleat”. *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11. Trakt i Ballit Kombëtar me titull “Demaskimi i squet”.

⁵³ M. Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane ...*, f. 319. Autori i referohet: *AQSH*, F. 251, V. 1943, D. 21, fl. 23.

⁵⁴ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11. Trakt i Ballit Kombëtar me titull “Demaskimi i squet”.

⁵⁵ M. Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane ...*, f. 319.

se çeta të Ballit kanë bashkëpunuar me pushtuesin gjerman, çka na sjell në pjesën tjetër të debatit: përmasat e këtij bashkëpunimi dhe sa institucional ishte ai. Të paktën deri në fund të tetorit të vitit 1943, nuk dokumentohet që Balli Kombëtar të ketë marrë ndonjë vendim në nivel të lartë politik për të bashkëpunuar qoftë me qeverinë shqiptare, qoftë me komandën gjermane. Sipas studiuesit Kasmi, marrëveshjet e bashkëpunimit me të gjitha çetat nacionaliste kishin karakter lokal.⁵⁶ Duke kryqëzuar referencat dhe burimet mund të arrijmë në konkluzionin se çetat e Xhafer Balit, Isa Manastirliut, Hamit Matjanit, Haki Blloshmit etj., të cilat në traktet e Ballit Kombëtar konsiderohen si të atashuara kësaj organizate⁵⁷, në dokumentet gjermane figurojnë si bashkëpunëtorë të tyre që gjatë muajit tetor 1943.⁵⁸ Për të gjitha këto nuk ka të dhëna që drejtuesit e Ballit Kombëtar të kenë pasur dijeni.

Ndryshe ndodh me një marrëveshje të arritur mes komandantit të Ballit Kombëtar për krahinat e Jugut, Kadri Cakrani* me komandën gjermane në Fier. Sipas dokumenteve gjermane, më 26 tetor 1943, Kadri Cakrani, “njoftoi divizionin se ai kishte marrë urdhër nga drejtuesi më i lartë i organizatës së tij, Mithat Frashëri, kushëriri i regjentit Frashëri, që të luftonte hapur kundër komunistëve, në krah të gjermanëve, e sidomos kundër brigadës së Mehmet Shehut dhe kundër Myslim Pezës”.⁵⁹ Një bisedë e tillë konfirmohet edhe nga Faik Quku. Sipas tij, rreth kësaj kohe, Kadri Cakrani dhe Qazim Shehu kishin shkuar të takonin anëtarët e KQ të Ballit Kombëtar, Mithat Frashërin, Hasan Dostin dhe Faik Qukun dhe “na njoftuen se për me i ba ballë rrezikut komunist kanë qenë të detyruem me marrë armë prej gjermanëve dhe kërkuen aprovimin tonë”.⁶⁰ Sipas kujtimeve të Qukut, KQ i Ballit kishte kundërshtuar, por, pasi Cakrani i kishte kërcënuar se, nëse nuk jepnin një aprovim të tillë, ai do të kalonte me komunistët, kishin pranuar në heshtje.⁶¹ Edhe vetë Cakrani në kujtimet e tij pohon të ketë arritur një marrëveshje të tillë me komandën

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *AQSH*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11. Trakt i Ballit Kombëtar me titull “Një skjarim me Partinë Komuniste”.

⁵⁸ M. Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane ...*, f. 334.

* Kadri Cakrani u emërua në këtë detyrë pas vrasjes së Hysni Lepenicës në luftimet e Grehotit në Gjirokastër me divizionin italian “Perugia”.

⁵⁹ M. Kasmi, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane ...*, f. 318.

⁶⁰ F. Quku, *Qëndresa shqiptare ...*, f. 367.

⁶¹ *Po aty*.

gjermane, si dhe të ketë njoftuar për këtë edhe drejtuesit e Ballit Kombëtar.⁶²

Nuk mund të konsiderohet ko incidencë që menjëherë pas kësaj marrëveshjeje komandat gjermane filluan të armatosnin popullsinë në disa krahina të vendit. Që në ditët e para të nëntorit, ka njoftime, veçanërisht në qarkun e Elbasanit, për komandat gjermane të cilat po armatosnin banorët e fshatrave.⁶³ Në të gjithë zonën po krijohej një situatë absurde pasi, sipas informacioneve, fshatarët kishin nxituar të merrnin armët “që të mos e djegë gjermani”. Të dy batalionet shprehnin shqetësimin se “fuqitë tradhëtare [kupto: Balli Kombëtar – S.B.] po bëjnë forca të mëdhaja” dhe, për këtë arsye, ato kishin marrë aksione për t’i mbledhur këto armë, aksione të cilat nuk kishin rezultuar të suksesshme. “Gjatë këtij operacioni zumë 6-7 pushkë kurse personat e tjerë nuk i shtimë dot në dorë mbasi kanë ikur me çetat balliste”.⁶⁴ Komandantët e të dy batalioneve kërkonin të dërgoheshin përforcime në mënyrë që të mund të mbledheshin armët e shpërndara nga pushtuesi.

Gjatë nëntorit nuk kemi mundur të gjejmë ndonjë urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ drejtuar Brigadave I dhe III në lidhje me ndonjë aksion të mundshëm për mbledhjen e armëve në zonën e Elbasanit. Brigada I ishte e zënë në këtë kohë në luftime me forcat e Ballit Kombëtar në Mallakastër, ndërsa Brigada III kishte ngecur në luftime në Pezë, ndërkohë që urdhri i Shtabit ishte të shkonte drejt Dibërës. Por

⁶² Kadri Cakrani, *Të vërtetat e luftës sime*, Tiranë: Onufri, 2020.

⁶³ Kështu në informacionin e Batalionit të Bërzeshtës më 4 nëntor 1943 thuhej “Bajmë me ditë atë komandë se pardje më datën 1 nandor 1943, gjermanët kanë sjellë me mijëra armë e municione dhe një sasi mitraloza e mortaja, të cilat i kanë depozituar në Hanin e Hotolishtit buzë rrugës. Këto armë gjermanët iau kanë dorëzue tradhëtareve të popullit “ballistëve”: Hasan bej Velçani, Haki Blloshmi dhe Daut Gurrës, të cilat këta i shpërndanë gjatë këtyre ditëve në katundet: Librazhd, Dragostun, Hotolisht, Kokrenë, Vulçan, Vehçan, Xhyrë, Dardhë, e Spatharë” (*AQSH*, F. 41/APL, V. 1943, D. 18, fl. 2. Informacion i Batalionit të Bërzeshtës për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 4 nëntor 1943). Pesë ditë më vonë informacion të njëjtë i dërgohet Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ edhe nga Batalioni i Sopotit, duke shtuar “Armët ndahen nga këta persona: Haki Blloshmi, Hasan Velçani, Haziz Biçaku, Daut Gurra, Ali Cakrani, Nezir Muzhaqi dhe Sheme Prangova për të cilin thuhet se ka ardhur në Pishkash” (*Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 14, fl. 1. Letër e çetës së Sopotit për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 9 nëntor 1943).

⁶⁴ *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 18, fl. 2. Informacion i Batalionit të Bërzeshtës për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 4 nëntor 1943; *po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 14, fl. 1. Letër e çetës së Sopotit për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 9 nëntor 1943.

PKSH e përdori shumë mirë këtë informacion për të denoncuar bashkëpunimin e Ballit Kombëtar me pushtuesit gjermanë para Aleatëve. Më 14 nëntor 1943, Enver Hoxha dhe Spiro Moisiu i dërguan një letër shefit të misionit britanik të sapovendosur në Shqipëri, Edmund Frank Davies, ku e njoftonin se “Nga shërbimi ynë i informacionit na njoftojnë se gjermanët dhe elementët e Ballit Kombëtar përgatisin një sulm mbi krahinën e Elbasanit. Forcat gjermane janë grumbulluar nëpër qytete dhe në krahinat përreth bandat e Ballit të komanduara nga Nezir Muzhaqi, Haki Blloshmi etj., kanë qenë armatosur nga nazistët”.⁶⁵

Me fillimin e nëntorit 1943, Mit’hat Frashëri, duke parë çetat e Ballit Kombëtar që nuk po përballonin më presionin e vazhdueshëm të forcave të UNÇ-së dhe, ndoshta, me idenë për të shmangur rënien e mëtejshme në bashkëpunim me gjermanët, Balli Kombëtar kërkoi ndihmën e qeverisë shqiptare. Më 2 nëntor 1943, Mit’hat Frashëri i shkroi një letër kreut të Regjencës, Mehdi Frashërit. “Këtu fuqit shqiptare, - shkruante Mit’hat Frashëri, - po bëjnë gajret të math kundra sulmeve të komunistave dhe me ndihmën e Zotit kemi shpresë ta fitojmë luftën dhe të shpëtojmë jeta dhe nderi i shqiptarëvevet”. Ai tregonte për disavantazhin që kishin dy grupet ndërluftuese në furnizime dhe ndihma. Sipas kreut të Ballit, “armiqt [kupto: forcat e LNÇ-së – S.B.] janë të pajisur me armë të shumta, me municione, me roba dhe këpucë edhe ndihma u vjenë nga grekët, nga makedonët dhe nga grekofonët, italianët dhe serbët”, ndërkohë që “Neve na mungojnë të gjitha. Por edhe më tepër kemi nevojë të ngrehim edhe moralin e popullit”.⁶⁶ Për këtë arsye, Frashëri kërkonte që “të na çoni një fuqi të mjaftueshme nga veriu, Kosova etj. dhe me këtë mënyrë të dëftohet se edhe ata vllëzër interesohen për neve dhe ndihmojnë që të shpëtojmë dhe të mprojmë së bashku këtë Shqipri”.⁶⁷ Përgjigjen e kreut të Regjencës, Mehdi Frashëri, për këtë letër, nuk kemi mundur ende ta gjejmë, por dokumente të tjera na bëjnë të mendojmë se përgjigjja duhet të ketë qenë pozitive. Vetëm një muaj e gjysmë më vonë, më 21 dhjetor 1943, Kadri Cakrani njoftonte kunatin e tij Xhelal Staravecka, të shkëputur rishtazi nga formacionet partizane, se “nga Kosova kanë aritur në Shkodrë 2000 e më shumë ushtarë të regulltë

⁶⁵ *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 41, fl. 34. Letër e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ drejtuar gjeneral Davies, 14 nëntor 1943.

⁶⁶ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 2, fl. 2. Letër e Mit’hat Frashërit për Mehdi Frashërin, Berat 2 nëntor 1943.

⁶⁷ *Po aty*.

Kosovarë, të cilët masi bënë pastrimin në Shkodrë duke arestuar 350 veta, kanë filluar të vinë Tiranë.⁶⁸ Në ditët e para të janarit, Gogo Nushi raporton se në kontrollin e ushtruar në Tiranë, më 23 dhjetor 1943 merrnin pjesë edhe shqiptarë të Kosovës. “Më 23 dhjetor, - raporton ai, - bllokuan qytetin për 36 orë rrjesht dhe kontrolluan pjesën e qytetit që ndodhej Bashkia dhe Lart. Në këtë kontroll muarrën pjesë një numër i madh kosovarësh”.⁶⁹

Rezistencë nacionale dhe luftë ideologjike

Ndryshe nga drejtuesit e Ballit Kombëtar, drejtuesit e PKSH-së u treguan më të vendosur në strategjinë e tyre afatgjatë, të ndihmuar edhe nga këshillat e aleatëve të tyre më të ngushtë, Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Pikërisht në këtë kohë, kur i ishte shpallur luftë si Ballit Kombëtar, ashtu edhe pushtuesve gjermanë në KQ të PKSH-së mbërriti një letër nga Josip Broz Tito. Letra i drejtohej Miladin Popoviçit dhe, ndërsa konfirmonte shumë prej vendimeve të cilat ishin marrë ndërkohë, sidomos në organizimin e ushtrisë, ofronte njëkohësisht udhëzime për rrugën që duhet të ndiqte PKSH-ja në të ardhmen, kryesisht në lidhje me pushtetin politik.⁷⁰ Përtej kësaj, Tito porosiste të vijohej me krijimin e njësisive më të mëdha ushtarake: batalione, divizione etj., por duke ruajtur njësitë më të vogla për “aksione të vogla, mobilizim luftëtarësh të rinj dhe mbrojtjen e pushtetit popullor të krahinave”.⁷¹ Ai këshillonte kujdes edhe ndaj misionëve britanike, të cilët nuk duhej në asnjë mënyrë të futeshin në çështje që i takonin politikës së brendshme.

Këshilla më e rëndësishme që dha Tito lidhej me pushtetin politik. Ai këshillonte drejtuesit komunistë të ecnin drejt krijimit të qeverisë pa

⁶⁸ *Po aty*, F. 556, V. 1943, D. 41, fl. 1. Letër e Komandës së Operacionit të Jugut të Ballit Kombëtar drejtuar Komandës Operative, 21 dhjetor 1943.

⁶⁹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1944, D. 44, fl. 1. Letër e Gogo Nushit për KQ të PKSH-së, 3 janar 1944.

⁷⁰ Faktin se vija politike e ndjekur nga PKSH-ja ishte në përputhje me këshillat e Titos e konfirmon vetë Enver Hoxha në një letër që i shkruan Nako Spirut, ku shprehet se në “disa letra që kemi marrë tash prej andej (Jugosllavia – S.B.) ku na shkruajn për çështjen e Inglezëve, të ushtëris dhe të Kosovës, ku na tregojnë se si duhet të qëndrojmë për këto çështje, shohim se jemi në rregull”. Për më tepër *shih: AQSH*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 23-24. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, pa datë.

⁷¹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 39, fl. 30-31. Letër e Titos për Miladin Popoviçin, 9 tetor 1943. (Letra është e përkthyer në shqip).

humbur kohë dhe pa pritur të përfundonte lufta. Sipas Titos, në Shqipëri kushtet ishin optimale. “Tek ne, - porosiste Tito, - Komiteti Antifashist i Çlirimit Popullor të Jugosllavisë është organi më i lartë i pushtetit popullor në gjithë vendin. Edhe pse ai asht një trup politik i gjithë partive, Kryesia e tij nuk është Qeveri në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse n’emigracion ndodhet Qeveria Jugosllave të cilën Aleatët t’onë akoma e njohin, me gjith që ne nuk e njohim. Kjo gja ne na lidh duart që nuk mundemi me formue një qeveri popullore edhe pse ne ktu do t’a dëshirojshim. Sikurse thash tek ju situata është ndryshe dhe ju do të mundeshi me një herë brenda në vendin t’uej me formue një Qeveri popullore, e cila do të mbështetet në Kshillat e Çlirimit Popullor dhe e cila do të kishte me të vërtet karakterin e drejt popullor”.⁷²

Letra është shkruar më 9 tetor 1943, por nuk dihet se kur ka mbërritur në KQ të PKSH-së. Gjithsesi, gjatë muajit nëntor, KQ i PKSH-së dërgoi një sërë letrash dhe qarkoresh, të cilat dukeshin si një zbërthim i këshillave të Titos. Në qarkoren e 3 nëntorit 1943, e njohur ndryshe si “qarkorja e Shpatit”, vija politike e PKSH-së në raport me Luftën Nacionalçlirimtare, Aleatët, planet për pushtetin e së nesërmes, tanimë ravijëzohej shumë qartë. Për drejtuesit e lartë të PKSH-së, situata në frontet kryesore të luftës diktonte një ndryshim të politikave. Pas dështimeve gjermane në frontin sovjetik, humbja e fuqive të Boshtit ishte çështje kohe, por kjo krijonte një tjetër problem për lëvizjen komuniste në të gjithë Botën, pasi “reaksioni ndërkombëtar” nuk kishte më mbështetje nazizmin, por Britaninë e Madhe dhe SHBA-në, të cilat nuk janë “mundu me e shtyp reaksionin n’Evropë, por vetëm me e shkëput nga Hitleri”.⁷³

Ndryshe nga më herët, kur strukturave lokale partiake u kërkohej të propagandonin kryesisht Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe të mos “sovjetizonin” këshillat nacionalçlirimtarë, tanimë qarkorja kërkon të promovohet rolit drejtues i PKSH-së në rezistencën kundër pushtuesit, duke thelluar karakterin ideologjik të saj. Qarkorja shpalos mënyrën si duhet të prioritarizoheshin aleancat dhe zbatoheshin disa parime të tjera të teorisë marksiste, njëra prej të cilëve ishte ai i internacionalizmit proletar. Strukturave të PKSH-së u kërkohej “t’i hedhim sytë drejt Moskës dhe çdo gjë ta shohim në prizmin e luftës që bën Bashkimi

⁷² *Po aty.*

⁷³ *Po aty.*

Sovjetik”. Në të njëjtën kërkohet popullarizimi i të gjitha lëvizjeve nacionalçlirimtare të Evropës dhe “veçanërisht i jugosllavëve dhe grekëve”.⁷⁴ Madje, për këtë të fundit, strukturat porositen “ta shtrojnë haptaz dhe pa ndroje problemin e vëllazërimit t’onë me popullin jugosllav edhe grek ... duhet me e bind popullin se lëvizja nacionalçlirimtare jugosllave dhe greke jo vetëm nuk e cenon independencën tonë, por e garanton atë dhe tani na ndihmon për ta fitue”.⁷⁵ Që krijimi i aleancave bëhej mbi baza ideologjike e dëshmojnë edhe këshillat që jepte Hoxha për qëndrimin që duhej mbajtur ndaj misionëve britanike. Ndonëse ato ishin të vetmet që kishin mbërritur në Shqipëri dhe po ndihmonin si me ndihma e financime, ashtu dhe për trajnimin e partizanëve, komunistët këshilloheshin të bënin kujdes dhe të mos i lejonin oficerët britanikë të hynin në sekrete të brendshme të PKS-së dhe LNC-së.

Qarkorja përsërit edhe një herë qëndrimin ndaj Ballit Kombëtar, me ndryshimin që ai etiketohej tanimë si një organizatë kolaboracioniste dhe lufta kundër tij konsiderohej pjesë e rezistencës kundër pushtuesit. Si Balli do të trajtoheshin edhe të gjitha organizatat, partitë apo individët që nuk pranonin të përfshiheshin në Frontin Nacionalçlirimtar, pasi jashtë tij, ato bënin lojën e armikut. Në këtë aspekt, qarkorja i referohej një koncepti tjetër leninist, atij të mobilizimit të masave. E. Hoxha porosiste vartësit e vet të bënin kujdes të ndanin “popullin nga reaksioni”⁷⁶ dhe, me

⁷⁴ Në po këtë linjë dhe në kundërshtim me qasjen nacionaliste të Ballit Kombëtar, qarkorja kritikon politikën e nacionalistëve shqiptarë, të cilët me ndihmën e Hitlerit “mundohet të mobilizojë popullatën shqiptare të Kosovës dhe të Maqedhonis kundër popullatave serbo-malazeze-maqedhone dhe e përdor çështjen e Kosovës për të hedhur mjegull dhe diversion në radhët e popullit shqiptar dhe me frymëzue pseudo-patriotët të luftojnë lëvizjen nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”. Për më tepër *shih: Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 52. Qarkore e KQ të PKS-së për të gjitha komitetet qarkore, 3 nëntor 1943.

⁷⁵ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 11, fl. 55. Qarkore e KQ të PKS-së për të gjitha komitetet qarkore, 3 nëntor 1943.

⁷⁶ Kjo porosi e Enver Hoxhës i referohej një ngjarjeje të rëndë të ndodhur më 24 tetor 1943 në Lushnjë. Aty partizanët e Brigadës I me urdhër të komandantit të saj, Mehmet Shehu, kishin ekzekutuar 65 fshatarë të rreshtuar në çetat e Ballit Kombëtar. Në të vërtetë, ekzekutime të tilla në grup nuk ishin raste kaq të veçuara. Edhe më herët, Gogo Nushi i ankohej Enver Hoxhës për pushkatimin pa arsye të 6 xhandarëve, të cilët ishin dorëzuar te forcat partizane, madje një pjesë e tyre ishin të lidhur edhe me LNC (AQS, F. 14/APL, V. 1943, D. 26, fl. 19-20. Letër e Gogo Nushit për Enver Hoxhën, 19 tetor 1943). Në atë rast, Hoxha kishte përligjur veprimet e Brigadës I. “Çështja e

anë të organizatave të masave: këshillave nacionalçlirimtare, rinisë antifashiste, gruas antifashiste ta mobilizonin në luftë kundër pushtuesit. Mosangazhimi dhe indiferenca konsideroheshin po aq të dëmshme sa përfshirja në organizata jashtë LNÇ-së.

LNÇ në vështirësi: operacionit ndëshkimor gjerman i dimrit

Nëntor-dhjetori i vitit 1943 ishte shumë sfidues për forcat e UNÇ. Deri në atë moment vëmendja kryesore ishte përqendruan për të neutralizuar dhe defaktorizuar Ballin Kombëtar. Sipas të dhënave dokumentare, forcat e UNÇ kishin mundur të vendosnin kontrollin pothuajse në të gjitha zonat e Shqipërisë së Jugut. Sipas një letre të Shtabit të Zonës I Operative në të gjithë zonën kishte filluar “spastrimi i përgjithshëm i Ballit. Lëvizja e trupave tona të mbahet konspirative. Në

xhandarëve që ka vrarë brigada, - shkruante Hoxha, - s’është as pak një arsye që t’ju alarmojë dhe Brigada ka pas fare të drejtë që t’i pushkatojë dhe ju keni gabuar që e keni hequr shënimin në komunikatë. Na duket se direktivat janë të kiarta për xhandarmërinë, pse keni ju dy tre miq jo personalë, por të punës, nuk mund të shtrembërohet direktiva”. (*Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 27, fl. 8. Letër e Enver Hoxhës drejtuar Gogo Nushit, pa datë). Ngjarja e Lushnjës, për përmasat që kishte dhe shkallën e brutalitetit, bëri shumë bujë në popull, gjë që shqetësoi dhe shkaktoi reagimin e drejtuesve të lartë të PKSH-së. Më 31 tetor 1943, Enver Hoxha i dërgoi një letër Mehmet Shehut ku i kërkonte shpjegime mbi ngjarjen (*Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 4, fl. 38. Letër e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ drejtuar komandës së Brigadës I, 31 tetor 1943). Më herët, vetë Mehmet Shehu i kishte shkruar një raport Shtabit, ku tregon një lloj pendese për përmasat që kishte marrë ngjarja. Ai pohon se ishte shtyrë nga “urrejtja kundër ballistavet trathëtarë, i revoltuar nga krimet dhe trathëtit e tyre, i rrëmbyer nga temperamenti mikro-borgjes i çasteve, qesh i mejtimit për këtë masë të pa masë. Reflektoj dhe bindem se masa ka qënë tepër e rreptë dhe se terrori i përdorur ka qënë pjesërisht i pa vënd.” (*Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 32, fl. 10. Letër e Mehmet Shehut për Komitetin Qendror, 30 tetor 1943). Më 5 nëntor 1943, Shehu iu dërguan dy letra, njëra personale nga Enver Hoxha, tjetra nga komandanti dhe komisari i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së. Në thelb, të dyja letrat kritikonin veprimin e Shehut për ekzekutimin e 65 fshatarëve të lidhur me Ballin Kombëtar, me një ndryshim thelbësor. Letra e Enver Hoxhës tërhiqte vëmendjen se “veprime të tilla jo vetëm që nuk sjellin dobi, por dhe na dëmtojnë”. Enver Hoxha porosiste se “S’duhet të armiçësohemi me katundarët pse ata janë shtyllat e partis s’onë, dhe një sjedhje [sjellje – S.B.] si e juaja sigurisht ka reprekursione ndër shtresat katundare. Në asnjë mënyrë s’duhet t’i japim armikut të na akuzojë për asisoj që nuk jemi” (*Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 79, fl. 1. Letër e Shpatit (Enver Hoxhës) drejtuar Mehmet Shehut, 5 nëntor 1943). Incidenti u mbyll, në atë kohë, me një tërheqje vërejtje për komandantin e Brigadës I, Mehmet Shehun.

Vlorë spastrimi gati mbaroi. Në Mallakastër spastrimin e bën Brigada I. Berati u spastrua”.⁷⁷ Bedri Spahi u si sekretar politik i Zonës urdhëron përpilimin e një liste të ballistëve “që duhen qëruar në Gjirokastrë. Këtu spastrimi duhet të bëhet i plotë. Mos harroni kategorinë e Hajro Latës. Pasurija e atyre që do të vriten do të konfiskohet duke lënë një sasi për familjet e tyre. Do të konfiskohet edhe pasuria e atyre që arratisen për të mos rënë në dorë të ushtrisë sonë. Të hetohen ku i kanë depot me ushqime dhe plaçka të ndryshme”.⁷⁸ Lajme të ngjashme vijnë edhe nga Vlora ku “Mbas sulmit qi hordhitë komuniste u banë çetavet t’ona në Gjormë, si dikur banë dhe hordhitë fashiste, të kuqt kanë pushkatue ma shumë se 50 vetë në katundet Gjormë, Lepenicë, Smokthinë, jo vetëm por mbas plaçkitjes më të turpëshme, ata kanë djegun në Smokthinë 20 shtëpi, në Gjormë 25 shtëpi, në Lepenicë 12 shtëpi”.⁷⁹

Balli u përgjigj me të njëjtën monedhë. Më 3 dhjetor 1943, forcat e Ballit Kombëtar në Vlorë, të irrituara nga ngjarjet e ndodhura në Gjorm e Dukat, filluan të mobilizojnë me forcë qytetarët. Për shkak të kundërshtimit të tyre për t’iu bashkuar çetave të Ballit, ato plagosën një djalosh dhe arrestuan shumë të tjerë.⁸⁰ U desh ndërmjetësimi i komandës gjermane të qytetit që banorët e arrestuar të liroheshin. Prefektura nxori një shpallje, ku garantonte qytetarët për kthimin e qetësisë dhe rregullit dhe siguronte se mobilizimi i popullsisë, nëse do të linte nevoja, do të bëhej vetëm nga organet qeveritare.⁸¹ Në kuadrin e veprimeve hakmarrëse të Ballit, është edhe ngjarja e 5 dhjetorit 1943, në Gostivisht

⁷⁷ *Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 8, fl. 3. Raport i Shtabit të Zonës I Operative (Bedri Spahiut) për komitetin qarkor të PKSH për Gjirokastrën (Laskës, Shkëmbit), 16 nëntor 1943.

⁷⁸ *Po aty*. Urdhri i Bedri Spahiut u zbatua dhe vetëm pak ditë më vonë nga komiteti qarkor i PKSH-së për Gjirokastrën vjen njoftimi se “U vumë në kërkim të ballistëve që ishin fshehur e kështu gjer më sot janë ekzekutuar këta eksponentë të Ballit: Safedin Hajdëri, Vasil Shahini (ky si shovinist e mbante korrespondencën e Zervës me majorin engles Bill), Hajro Lata, Myzader Shehu, Duro Shehu, Mato Mataj, Boço Kalo, Tare Kalo, Tajar Çarçani të tjerë janë çarmatosur e të tjerë kërkohmë për të ekzekutim”. (*Po aty*, F. 17/APL, V. 1943, D. 3, fl. 9. Raport i komitetit qarkor të Gjirokastrës për KQ të PKSH).

⁷⁹ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11. “Nдалu o BARBAR!”, Trakt i Ballit Kombëtar, 2 dhjetor 1943.

⁸⁰ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 141, fl. 79. Informacion i prefekturës së Vlorës drejtuar Zyrës Politike të MPB, 3 dhjetor 1943.

⁸¹ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 141, fl. 79. Shpallje e Prefekturës dhe bashkisë së Vlorës, 2 dhjetor 1943.

të Kolonjës. Anëtari i Ballit Kombëtar, Mustafa Gostivishti dhe vëllezërit e tij, vranë në kishën e fshatit prindërit e 9 partizanëve, si hakmarrje për vrasjen e nipit të tyre, akt ky që u dënua nga drejtuesit e Ballit Kombëtar të Korçës.⁸²

Ndërsa Lëvizja Nacionalçlirimtare fitonte terren ndaj Ballit Kombëtar, situata në skenën e madhe të Luftës së Dytë Botërore po ndryshonte me shpejtësi. Në takimin e tetorit 1943 në Teheran midis tre Aleatëve të Mëdhenj: SHBA, Bashkimi Sovjetik, Britani e Madhe u morën vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e Evropës. Mundësia që Ballkani të ishte fronti i dytë i Aleatëve u përjashtua. Ky front u vendos të hapej së shpejti në përfundim të Evropës. Ndërkohë që presioni ushtarak i Aleatëve në Shqipëri filloi të binte dhe me afrimin e dimrit u bë e qartë se, të paktën për momentin, nuk do të kishte zbarkim, ushtria gjermane mendoi se ishte momenti i duhur për të eliminuar forcat e rezistencës. Një seri operacionesh gjermane filluan gjatë nëntor-dhjetorit të drejtuara krejtësisht kundër forcave ushtarake dhe prapavijave të UNÇ.

Suksesi i arritur në sulmet kundër Ballit, dhe fuqizimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare me sa duket, nuk mundësoi të njëjtin sukses edhe në betejat kundër forcave ushtarake gjermane. Këta të fundit, ndryshe nga pushtuesit italianë të cilët angazhuan forca të mëdha ushtarake, adaptuan një strategji ushtarake të ngjashme me luftën guerile që bënin partizanët. Ata sulmonin në formacione të vogla me 50-70 vetë dhe godisnin shpesh dhe befasisht. “Taktika që përdor armiku, - shkruhej në një letër të Shtabit të Përgjithshëm, - është të sulmojë dhe të sulmojë sa më shumë që mos na lërë të marrim frymë”.⁸³ Në disa raste sulmonin pas betejave mes Ballit dhe UNÇ, duke i vendosur në vështirësi forcat e lodhura partizane. Shumë beteja të forcave partizane kundër pushtuesve gjermanë gjatë muajit nëntor si në Pezë, Dibër, Mokër, Pogradec etj. i kishin gjetur të papërgatitur dhe rezultuan në humbje ose të pozicioneve (Dibra, Peshkopia e, më vonë Berati, Mallakastra etj., u pushtuan nga forcat gjermane)⁸⁴, ose të materialeve ushtarake (ushtria gjermane nuk arriti ta

⁸² S. Butka, *Lufta Civile ...*, f. 280.

⁸³ AQSH, F. 41/APL, V. 1943, D. 4, fl. 12. Letër e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ drejtuar komandës së Brigadës I, 5 nëntor 1943.

⁸⁴ Për tre betejat e zhvilluara në Dibër *shih: Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 20, fl. 7. Letër e Batalionit të Martaneshit për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 12 nëntor 1943; *po aty*, fl. 8. Letër e Batalionit të Martaneshit për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ

merrte Pezën, e cila mbeti nën kontrollin e komandës partizane të Grupit të Pezës. Pavarësisht kësaj, Brigada III raportonte se gjatë tërheqjes në kushte të vështira të motit dhe lodhjes të luftëtarëve u detyrua të linte një pjesë jo të vogël të armatimeve).⁸⁵

Situata e shqetësoi edhe Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ. Në një letër që ai i dërgonte Mehmet Shehut, më 5 nëntor 1943, shprehej se “në çdo vend që këto formacione gjermane janë futur i kanë gjetur shokët tanë në gjumë dhe të pakujdesshëm”.⁸⁶ Për forcat partizane situata u rëndua pas mesit të nëntorit dhe, veçanërisht, gjatë muajit dhjetor kur komanda gjermane filloi zbatimin e një sërë operacioneve ndëshkimore.⁸⁷ Pothuajse të gjitha formacionet pësuan humbje të konsiderueshme si në njerëz, ashtu dhe në materiale, por ajo që u ndje më shumë ishte ulja e moralit të partizanëve. Gjatë muajit dhjetor, brigadat II dhe III pësuan humbje të ndjeshme për shkak të dezertimeve në masë, duke reduktuar ndjeshëm numrin e efektivave të tyre. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ, së bashku me një pjesë të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, të cilët kishin shkuar në Shëngjergj për t’u takuar me

(Ramadan Çitakut), 14 nëntor 1943; *po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 42, fl. 19. Letër e Frederik Nosit për Enver Hoxhën, Martanesh, 22 nëntor 1943, ora 8 am. Për hyrjen e trupave gjermane së bashku me ato të Ballit Kombëtar në Berat, më 19 nëntor 1943 shih: F. Kuku, *Qëndresa e shqiptarëve ...*, vëll. II, fl. 321.

⁸⁵ *AQSH*, F. 41/APL, V. 1943, D. 34, fl. 3. Raport i Brigadës III për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ mbi gjendjen në Pezë pas operacionit gjerman të 6 nëntorit, 13 nëntor 1943.

⁸⁶ *Po aty*. F. 41/APL, V. 1943, D. 4, fl. 12. Letër e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ drejtuar komandës së Brigadës I, 5 nëntor 1943.

⁸⁷ Më 5-10 nëntor 1943 filloi “Operacioni 505” që synonte eliminimin e forcave partizane të Myslim Pezës dhe spastrimin e vijës Tiranë-Kavajë-Peqin-Elbasan. Operacioni përfundoi pa shkatërrimin e forcave partizane, por ata pësuan humbje jo të vogla, duke përfshirë edhe vrasjen e dy radistëve britanikë. Nga 15 nëntori 1943 filloi operacioni i koduar “Burri i Kuq” me destinacion Berat-Fier-Lushnjë. Vetëm pas 4 ditësh, Berati ra në duart e forcave gjermane. Në po të njëjtën mënyrë u mor nga forcat gjermane edhe rajoni i Mallakastrës, në të cilin forcat e UNÇ-së kishin fituar kontroll pas shkatërrimit të nacionalistëve. Gjatë muajit dhjetor operacionet e koduara “Otto”, “Sulmi”, “Rrethimi i malit” etj., përfshinë pothuajse të gjitha krahinat e Shqipërisë së Jugut dhe Qendrore të përqendruara veçanërisht në Vlorë-Tepelenë, Elbasan, Korçë e Gjirokastër. Për më tepër mbi operacionet ndëshkimore gjermane ndaj forcave të UNÇ shih: M. Kasmë, *Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane ...*, f. 326-332.

Abaz Kupin, dhe misionin britanik në Shqipëri mbetën të izoluar në zonën e Çermenikës.⁸⁸

Arsyet për një situatë të tillë në rradhët e dy brigadave partizane janë të shumta. Gjatë muajve nëntor-dhjetor pothuajse të gjitha formacionet partizane ankoheshin për mungesa të shumta si në pajisje ushtarake, ashtu edhe në veshmbathje. Në një raport të batalionit të Çermenikës dëshmohet qartazi kjo gjendje. “Forca është prej 64 vetash, - thuhet në raport, - nga këta gjysma janë të çetës së Shëngjergjit të cilët siç ju kam shkrojtur edhe në një letër tjetër janë pa municion, sidomos 15 partizanë kanë 1-4 ballë fyshek e kush pa to fare. Shokët janë të gjithë të rinj udhëheqës ushtarak nuk kemi. Çdo ditë na sëmuren shokë nga shkaku i të ftohtës, mbassi nuk janë edhe të veshur mirë”.⁸⁹ Këto mungesa në kushtet e dimrit të ashpër të vitit 1943-1944 u bënë edhe më të theksuara, duke ulur moralin dhe motivimin e partizanëve.

Pjesa më e madhe e efektivave të brigadave II dhe III përbëheshin nga vullnetarë të rinj në moshë të cilëve u mungonte si përgatitja ushtarake, ashtu dhe politike. Në komunikimet e drejtuesve më të lartë të PKSH-së vihej në dukje numri i vogël i komunistëve në formacionet partizane. Në nëntor 1943, Enver Hoxha i kërkonte Nako Spirut të dërgonte 10-15 komunistë nga Tirana e Durrësi për brigadën II dhe III, pasi përgatitja ideologjike t tyre linte shumë për të dëshiruar.⁹⁰ Kjo situatë në një kohë kur kishte filluar ideologjizimi i rezistencës ishte e padëshirueshme për drejtuesit e lartë të PKSH-së. Por kjo ishte vetëm njëra anë e medaljes. Ana tjetër lidhej me faktin se, mungesa e përgatitjes ideologjike, ndikonte drejtpërdrejt në motivimin e partizanëve. Përballë sulmeve të vazhdueshme të ushtrisë gjermane, të ftohtit, urisë ata u frikësuan dhe kërkuan të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Në një raport të komandantit të Brigadës II, Beqir Balluku dëshmohet shumë qartë ky

⁸⁸ Mbi rrethimin e Shtabit të Përgjithshëm, anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe misionit britanik është shkruar shumë. *Shih: Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar ...*, vëll. III, f. 447-462; Enver Hoxha, *Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 87-166; R. Hibbert, *Fitorja e hidhur ...*, f. 121-136; R. Bailey, *Lufta e fshehtë ...*, f. 141-154. Autori i referohet kryesisht ditarit të mbajtur nga koloneli Nichols; si dhe *AQSH*, F. 14/AP (kujtme), fl. 4-17. Kujtimet e Ymer Dishnicës, 30 korrik 1968.

⁸⁹ *AQSH*, F. 41/APL, V. 1943, D. 16, fl. 2. Letër e komisarit dhe n/komisarit të Batalionit të Çermenikës për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 13 dhjetor 1943.

⁹⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 23-24. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, pa datë.

realitet. “Elementi i ardhur nga Berati⁹¹ doli i gjithi fallco, një pjesë ka lënë luftën dhe ka dezertuar dhe një pjesë për ditë vjen dhe kërkon leje për të ikur, janë mjaft prej tyre që i kanë hedhë në lumë armët. Pjesa e dërguar prej Elbasanit është pjesë e mirë, por s’janë në gjendje t’i bëjnë ballë jetës partizane. Kjo vlen për ata që vijnë nga qyteti. Këtu vlen të përmendet edhe për elementa kuadro i cili pas aksionit është kthyer pothuajse gjysma e sëmurë dhe poshtë moralisht. Qëndron shumë mirë elementi që vjen nga Gjirokastra e veçanërisht nga Kurveleshi dhe Dumrea, masë që ne bazohemi dhe kemi shpresat veçse është i paktë ky element”⁹².

Strategjia e terrorit e aplikuar nga ushtria naziste frikësoi dukshëm popullsinë civile, duke kufizuar ndjeshëm mbështetjen materiale për formacionet e UNÇ-së. Kështu, më 20 nëntor 1943, sipas një njoftimi të prefekturës së Durrësit “komanda gjermane e vendit mbasi bëri një kontroll në këtë qytet ndaj banorëve për masa policore ka kapë në qytetin e Durrësit 569 shqiptarë, 38 italian dhe në Shijak 57 shqiptar dhe 44 italian”⁹³. E njëjta situatë dokumentohet edhe në qytetet e tjera. Sekretari politik i komitetit qarkor të PKS-së për Korçën, Pandi Kristo i kërkonte Shtabit t’i dërgonte përforcime pasi forcat partizane jo vetëm që nuk po përballonin dot sulmet gjermane, por “në popull nuk kemi një mbështetje të mirë, pse është frikësuar nga djegiet dhe terroret që bënë gjermanët në fushë, Kolonjë, Rrëzë. Prandaj kërkojmë një pjesë forcat prej të Brigadës të vijnë në qarkun tonë”⁹⁴. Situata për forcat partizane rëndohej edhe nga “besëlidhjet” e arritura në disa zona të vendit, kryesisht në veri të Shqipërisë, për të mos u dhënë ushqim edhe mbrojtje njëjësive partizane. Besëlidhje këto që i vuajtën edhe misionet britanike.⁹⁵

⁹¹ Nga komiteti qarkor i Beratit pas kërkesave të vazhdueshme të KQ të PKS-së u dërguan rreth 220 veta, pothuajse të gjithë punëtorë në Kuçovë. Ata të gjithë kishin mbërritur në brigadë në fund të nëntorit. Enver Hoxha i ankohej Nako Spirut se të gjithë elementët e dërguar nga Berati, vetëm një ishte anëtar i PKS-së. Shih: *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 23-24. Letër e Enver Hoxhës për Nako Spirun, pa datë.

⁹² *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 33, fl. 6. Raport i Brigadës II për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ, 18 dhjetor 1943.

⁹³ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 93, fl. 9. Telegram nr. 6115 i prefekturës së Durrësit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 nëntor 1943, ora 10.

⁹⁴ *Po aty*, F. 41/APL, V. 1943, D. 36, fl. 13. Raport i Pandi Kristos drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së mbi gjendjen në Korçë, 4 dhjetor 1943.

⁹⁵ Për më tepër shih: R. Hibbert, *Fitorja e hidhur ...*, f. 140.

Arsyeja më e rëndësishme ishte bashkëpunimi i forcave të Ballit Kombëtar me pushtuesit gjermanë, duke krijuar një front të vërtetë përballë UNÇ-së. Ndërsa deri në këtë kohë mund të ngrihej hije dyshimi mbi marrëdhëniet e Ballit Kombëtar me autoritetet gjermane, ky operacion tregoi qartazi bashkëpunimin e pjesës më të madhe të strukturave të Ballit me pushtuesit gjermanë. Në Vlorë, Korçë, Elbasan, Lushnjë, Fier etj., forcat e Ballit Kombëtar kishin zënë qytetet duke ushtruar presion mbi popullsinë, siç ishte rasti i Vlorës ku Balli kërkonte të mobilizonte me forcë popullsinë e qytetit për ta përdorur kundër forcave partizane.⁹⁶ Humbjet që pësuan brigadat partizane në mes të dhjetorit 1943 me ushtrinë gjermane dhe çetat nacionaliste, Balli Kombëtar me anë të një trakti i konsideroi si fitore të saj.⁹⁷ Pas Kongresit të Ballit Kombëtar të mbajtur në Berat më 3 janar 1944, kolaboracionizmi i tij me gjermanët u institucionalizua. Më 9 janar 1944, Xhafer Bali një nga krerët ushtarakë të Ballit për Elbasanit i shkruante kolegut të vet, Halil Hoxhës se së shpejti ai me 600 vetë së bashku me “një baon gjerman do të hynte në Panarit”.⁹⁸ Në shkurt 1944, Balli Kombëtar pranoi të merrte pjesë në qeverinë kuislinge shqiptare me tre ministra, duke mos lënë asnjë dyshim për bashkëpunimin e saj me autoritetet gjermane. Qartazi Balli u përpoq të shfrytëzonte pozitën e vështirë në të cilën e kishte vendosur operacioni ndëshkimor gjerman Ushtrinë Nacionalçlirimtare për ta shkatërruar përfundimisht atë. Në përgjigje të një letre, ku kërkonte ndërmjetësimin e tij për të dërguar forca gjermane kundër ushtrisë partizane në Gjirokastrë më 9 shkurt 1944, Ali Këlcyra ndonëse shpjegonte se veprimet e Ballit dhe të gjermanëve nuk ishin të koordinuara, shprehej optimist se “se për pak kohë terrorizmin do ta çdukim dhe populli do të shpëtojë nga kjo murtajë e keqe”.⁹⁹ Një javë më vonë, krerët e Ballit Kombëtar, Mit’hat Frashëri dhe Kadri Cakrani takuan në Berat ministrin e Brendshëm, Xhafer Deva

⁹⁶ *AQSH*, F. 152, V. 1943, D. 141, fl. 79. Informacion i prefekturës së Vlorës drejtuar Zyrës Politike të MPB, 3 dhjetor 1943.

⁹⁷ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1943, D. 11. “Bataljonet i pari dhe i dyti të brigatës së tretë komuniste shpartallohen krejtësisht nga fuqitë nacionaliste të Ballit Kombëtar”, Trakti i Ballit Kombëtar, dhjetor 1943.

⁹⁸ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1944, D. 28, fl. 1. Letër e Xhafer Balit për Halil Hoxhën, 9 janar 1944.

⁹⁹ *Po aty*, F. 270/APL, V. 1944, D. 9, fl. 2. Letër e Ali Këlcyrës për Sulejman Beun, 7 shkurt 1944.

dhe vendosën krijimin e 4 divizioneve të një ushtrie të rregullt shqiptare në Berat, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë.¹⁰⁰ Sipas raporteve të të deleguarit special për Evropën Juglindore për Ministrinë e Jashtme gjermane, Hermann Neubacher, forcat nacionaliste antikomuniste në Shqipëri arrinin në 10 000 vetë, më të fuqishmet nga të cilat konsideroheshin forcat e Ballit Kombëtar “që ka afro 5000 vetë, nën udhëheqjen e Kadri Cakranit, bashkë me forcat tona, po lufton në Shqipërinë Jugore dhe nga komunistët ka marrë epitetin ‘Tmerri’”.¹⁰¹ Sipas këtij informacioni, armatimin për Ballin Kombëtar në Shqipërinë e Jugut “e ka dhënë divizioni i atjeshëm gjerman në marrëveshje me byronë time zyrtare”.¹⁰² Neubacher-i flet edhe për mobilizim të 14 grupeve të tjera të grumbulluara në një komandë speciale nga kapiteti SS, Lange, në të cilin bën pjesë dhe çeta e Aziz Biçakut që kishte kapur rob gjeneralin britanik, Edmund Frank Davies më 8 janar 1944.

Balli Kombëtar filloi gjithmonë e më shumë të mbështetej te një strategji politike dhe ushtarake që synonte mbijetesën ndaj sulmit të ardhshëm të UNÇ-së dhe, me mbështetjen e pushtuesve gjermanë, sigurimin e fitores ndaj tyre. Drejtuesit e Ballit nuk besonin në fitoren e Gjermanisë së Hitlerit, por ishin të sigurt se në përfundim të luftës, Aleatët Perëndimorë do të ishin të gatshëm të mbështesnin një forcë jokomuniste për qeverisjen e ardhme të Shqipërisë. Oficeri britanik i bazës Seaview (Panorama), Anthony Quayle e dëshmon fare qartë këtë strategji të Ballit. Për Muçon, Aleatët e Kombeve të Bashkuara do ta fitonin luftën dhe gjermanët ose do të dëboheshin nga Ballkani, ose do ta linin atë me dëshirën e tyre. Britania dhe SHBA nuk do të interesoheshin më për Ballkanin dhe “Atëherë do të fillojnë telashet, telashet e vërteta për Shqipërinë, edhe për Jugosllavinë, edhe për Greqinë”. S. Muço mendonte se nëse nuk eliminoheshin forcat komuniste që gjatë luftës “lëvizja komuniste, nën maskën e një lëvizje patriotike, atëherë do të jetë shumë e fortë. Atëherë gjithkush do të ketë një pistoletë të drejtuar në brinjët e tij dhe do të detyrohet të përshëndesë me grusht shtrënguar. Para

¹⁰⁰ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Koleksioni i dokumenteve gjermane, J-12, fl. 86. Raport politik dhe ushtarak i Gruparmatës F.

¹⁰¹ *Dokumente të institucioneve gjermane për historinë shqiptare 1941-1944*, përgatiti për botim dr. Hakif Bajrami, Prishtinë: Vatra, 1998, dok. nr. 137. “I deleguari special për Juglindje, Nojbaheri, Ministrisë së Punëve të Jashtme”, f. 179.

¹⁰² *Po aty*, f. 180.

kësaj unë do të përdor gjermanët, që tani ndodhen në Shqipëri, si armë për të shkatërruar komunistët”.¹⁰³

Parashikimet e Skënder Muços tingëllojnë gati profetike, por kjo nuk ndryshon faktin se strategjia e Ballit rezultoi e pasuksesshme për disa arsye. Forcat ushtarake të Ballit Kombëtar, të pastrukturuara mirë, të padisiplinuara dhe jo të motivuara si duhet, nuk mundën t’i bënin ballë sulmeve të forcave të UNÇ-së. Indiferentizmi fillestar ndaj pushtuesit gjerman dhe, më pas, bashkëpunimi me të, e bëri të pamundur që misionet britanike të mbështesnin Ballin.¹⁰⁴ Por, më 17 dhjetor 1943, për shkak të bashkëpunimit të Ballit me gjermanët dhe mospërfshirjes së legalistëve në luftë kundër pushtuesve, gjenerali britanik Davies propozoi një ndryshim në politikën britanike kundrejt forcave guerilase në Shqipëri. Në këtë telegram ai kërkoi denoncimin kolektiv dhe individual të anëtarëve të Këshillit të Regjencës, Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, pasi, sipas tij, të gjithë ata po bashkëpunojnë me gjermanët “të cilët i pajisin me armë në sasi të mëdha, duke i vendosur si roje në rrugët kryesore, si policë qytetesh dhe si drejtues patrullash, duke i lënë kështu të lira trupat gjermane”.¹⁰⁵ Në luftën e madhe botërore që po zhvillohej, rezistenca kundër ushtrisë gjermane ishte fjalëkalimi për çdo aksion a politikë që mund të ndërmerren misionet aleate në Shqipëri.¹⁰⁶

¹⁰³ Anthony Quayle, *Tetë orë nga Anglia. Kujtime të majorit britanik të SOE për luftën antifashiste në Shqipëri: 1943-1944*, Tiranë: Naimi, 2019, f. 118-119.

¹⁰⁴ Në fund të tetorit në Shqipëri mbërriti një mision zyrtar ushtarak britanik, i kryesuar nga gjeneral-brigade, Edmund Frank Davies, i cili kishte për qëllim të ndihmonte rezistencën e guerrilasve shqiptarë kundër nazistëve gjermanë, si dhe të nxiste të gjitha grupimet të përfshiheshin në këtë rezistencë. Ai zhvilloi takime me Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ-së (30 tetor 1943), Abaz Kupin nga Legaliteti (4 nëntor 1943) dhe Mit’hat Frashërin e Ballit Kombëtar (9 nëntor 1943). Në raportin që i dërgoi qendrës së tij në nëntor 1943, kishte doza optimizmi për mundësinë e përfshirjes së Legalitetit dhe Ballit Kombëtar në luftë kundër pushtuesve gjermanë. *Shih: AQSH*, F. 41/APL, V. 1943, D. 42, fl. 11 dhe 15. Letra të Frederik Nosit për Enver Hoxhën, mbi takimet e Davies përkatësisht me Abaz Kupin dhe Mit’hat Frashërin.

¹⁰⁵ *Shih: Hamit Kaba, Shqipëria dhe të Mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*, Tiranë: KLEAN, 2015, f. 201. “Telegram i gjeneral-brigade Davis drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të Forcës 133 në lidhje me situatën luftarake në Shqipëri dhe dënimin e Këshillit të Regjencës, Ballit Kombëtar dhe zogistëve si bashkëpunorë të gjermanëve, 17 dhjetor 1943”; R. Bailey, *Lufta e fshehtë ...*, f. 165; R. Hibbert, *Fitorja e hidhur ...*, f. 124-125.

¹⁰⁶ Që prej 22 qershorit 1941, kryeministri i Britanisë së Madhe duke braktisur politikën kundër Bashkimit Sovjetik, pati deklaruar se “Çdo njeri ose shtet që lufton kundër nazistëve do të ketë ndihmën tonë. Çdo njeri ose shtet që ndihmon Hitlerin është

Së fundi, Balli nuk mori në konsideratë faktorin “popull”, të cilin drejtuesit e PKSH-së e menaxhonin me shumë kujdes. Shqiptarët shihnin shqiptarë të tjerë, të cilët etiketoheshin si “ballista” të shërbenin si udhërrëfyes për ushtritë gjermane dhe si ndihmës të tyre në reprezaljet e shumta që ata bënë në shumë krahina të Shqipërisë, veçanërisht gjatë operacionit ndëshkëtor të dimrit. Për më tepër, çetat e Ballit Kombëtar nuk u sollën asnjëherë si ushtri e strukturuar dhe e disiplinuar. Shumë raporte të Ministrisë së Punëve të Brendshme flasin për sjellje të pahijshme të Ballit me popullsinë në disa krahina. Kështu, në Korçë njoftohet për krime ordinere si vjedhje e keqsjellje me banorët.¹⁰⁷ Këto veprime, të përforcuara edhe nga propaganda e PKSH/LNÇ-së, filluan të gërryenin në mënyrë të pariparueshme reputacionin e Ballit Kombëtar, duke e ulur në proces edhe ndikimin e tij politik.

S u m m a r y

THE POLITICAL SITUATION IN ALBANIA (OCTOBER-DECEMBER 1943): RESISTANCE, COLLABORATION AND CIVIL WAR

During the first months of Albania's German occupation, relations between the Communist Party of Albania (CPA) and the Balli Kombëtar (National Front) experienced increasing tension. The Korça region had become the first arena of armed clashes between the two political groups, while communist leaders were pushing their structures across the country to attack

armiku ynë”. Ky lloj qëndrimi ishte përsëritur disa herë nga krerët e Aleancës së Kombeve të Bashkuara. Në editorialin e gazetës “Mundimi” të 11 majit 1944, i cili fliste për falsitetin e asnjësisë të shpallur nga qeveria kukull shqiptare, ndër të tjera, i kujtonte shqiptarëve se, jo vetëm bashkëpunimi me nazistët gjermanë, por edhe indiferenca ndaj tyre nuk do të falej. “Siç dihet pas mbarimit të luftës, Aleatët fitues do të diktojnë kushtet e paqes. Të muejtunit do të paguejnë për dëmin dhe shkatërrimin, që ata u kanë shkaktue Kombeve Aleate, jo vetëm me të holla, porse edhe me punëtori të detyrueshme, me landë ndërtimi si dhe me tokë. Të paanshmit nuk kanë me pasë as një za në konferencën e paqës as ndihmë as shpërblim”. Shih: “Mundimi”, nr. 10, 11 maj 1944, në *Buletini arkivor ushtarak*, nr. 1-2, botim i AQFA, Tiranë: 2019, f. 55.

¹⁰⁷ *AQSH*, F. 556, V. 1943, D. 7. E gjithë dosja ka dokumente ku akuzohen anëtarë të Ballit për vjedhje të shtëpive në qytetin e Korçës, kërcënime ndaj banorëve në fshatin Vranisht etj.

militarily the Balli Kombëtar, and politically newly formed Zogist National Party.

In the first days of October, the leaders of both the CPA and the Balli Kombëtar issued several orders and instructions to their local structures that eventually formalized the civil war in Albania. For the CPA, all organizations or individuals who refused to join the National Liberation Movement were considered "enemies" or "traitors to the homeland", thus began to draw the profile of the "people's enemy", which took full shape after the World War Two. Balli Kombëtar identified communism as the greatest threat to the future of Albania and decided to cease the resistance against the Nazi occupiers and to concentrate all their military and propaganda efforts fighting against the National Liberation Movement.

In this clash, the Balli Kombëtar could not resist the organizational superiority and centralization of the National Liberation Army and began to seek military support even from the Nazi occupiers. At the beginning of November 1943, many of Balli's military forces were armed by the German army and joined the punitive operations launched by them against the National Liberation Army. The German winter operation managed to put UNÇ forces in serious difficulty, especially in Central and Northern Albania but failed to eradicate them. Although Balli's cooperation with the German occupiers had no ideological character and was done for purely pragmatic purposes, it affected negatively the organization's reputation. In December 1943, General Davies, the head of British Military Mission in Albania, considering Balli as a collaborationist organization, proposed to his superiors a policy changing towards Balli Kombëtar. Furthermore, the harsh behavior of the German military forces towards the civil population and Balli's participation during such operations, the lack of discipline of the military units of Balli Kombëtar, reinforced by the CPA propaganda against them, lowered the prestige of the organization in the eyes of the population, gradually diminishing its political influence.